# REPUBLIKA E KOSOVËS
## KUVENDI I KOMUNËS - SHTIME
**Nr.01-060/01-7129/24 datë: 19.03.2024**

**Npi – 01/128 datë: 28.03.2024**

Duke u bazuar në nenin 43 dhe 49 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, si dhe në bazë të nenit 3.13 të Rregullores së Punës së Kuvendit dhe Komiteteve, Npi – 01/114 të datës: 26.04.2019, për mbledhjen e Kuvendit të Komunës, të mbajtur më: 28.03.2024, është nxjerrë ky:

E KSTRAKT
**PROCESVERBAL**

I MBLEDHJES SË -III- TË RREGULLT, TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË SHTIMES
E thirrur për datën: 28.03.2024, (e enjte) në ora 10.°° , në sallën e Kuvendit.

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi, Anëtarët e Kuvendit: z.Besnik Seferi, z.Gëzim Haxhiu, z.Asllan Beqaj, znj.Shkurte Mustafa, znj.Sanije Sadiki, znj.Zejnije Veliu, z.Kadri Emini, znj.Rrezartë Ramadani, z.Muhamet Ademaj, z.Artan Lubovci, z.Përparim Ramusa, znj.Adelina Beqaj, znj.Albana Podvorica, znj.Besartë Musliu-Spahija, z.Rrahman Jakupi, z.Lumni Amrushi, z.Hasan Avdyli, z.Hamëz Tërshani, z.Reshat Mujota, dhe z.Rexhep Gashi.
Në mbledhje përveç anëtarëve të Kuvendit kanë marrë pjesë edhe Kryetari, z.Qemajl Aliu, Drejtorët, Shefja e Kabinetit - znj.Anita Kurti, ZKF-znj.Kimete Ukaj, RZSH - Muhamet Hoxha, Asistente e Kryesuesit - znj.Gentiana Mehmeti, Zyrtarët e IT-së, Zyrtare e Informimit - znj.Vlora Hyseni dhe praktikantet, znj.Valmira Hoxha, znj.Sadbere Halili dhe znj.Donjeta Qorrolli.
Mbledhjen e hapi Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit konstatoi, kuorumin e mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes së Kuvendit. Pastaj njoftoi Kuvendin se për këtë mbledhje është propozuar ky:

**REND DITE**

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më: 28.03.2024,
2. Propozim-Vendim për ndërrimin e de stinimit të ngastrave në ZK-Davidovc,
3. Propozim-Vendim për ndryshimin e vendimit të Kuvendit Npi-01-190 për Çerdhen në Petrovë,
4. Propozim-Vendim për marrjen e të drejtës së shfrytëzimit të paluajtshmerisë NPKSH "Higjiena" dhe "Kryqit të Kuq të Kosovës" në Shtime,
5. Pasqyrat Financiare për vitin 2023,
6. Propozim-Vendim për miratimin e vlerësimit të dëmeve të FN&FT për Janar-Tetor 2023,
7. Draft-Plani lokal i veprimit për komunitetet Rom e Ashkali për 2024-2026 (për diskutim publik)
8. Propozim-vendim për formimin e Komisioneve për ndarjen e titujve "Sakrifica e Reçakut-1999" dhe "Pena e Artë".
9. Pyetje – Përgjigje,

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Pasi përshëndeti të pranishmit në mbledhje, hapi diskutimin për rendin e ditës.

**Diskutimet:**

**znj.Adelina Beqaj;** Përshëndetje për ty Kryesues, për Kryetarin, drejtorët, zyrtarët, të nderuar anëtarë të Kuvendit të Komunës, gjithë të pranishmit,të dashur qytetarë të Komunës së Shtimes. Sa i përket rendit të ditës mbledhjen e kaluar kam propozuar të kemi informatë nga DSHMS-ja, por nuk e shoh që e kemi në rend dite, çka ka ndodhur dhe pse jo?

**z.Reshat Mujota:** Përshëndetje për të gjithë, përshëndetje për Kryetarin, qytetarët e Komunës së Shtimes. Sa i përket rendit të ditës pajtohem me shumë pika të rendit të ditës, po pajtohem edhe me propozimin e zonjës Adelina që kemi është dashur të kemi një raport nga Drejtoria e Shëndetësisë, të paktën një raport të na ofrohet nga drejtori i Shëndetësisë. Dua, pak më shumë, të fokusohem te pika 4, te Propozim-vendimi për marrjen të drejtës së shfrytëzimit të lokacionit të NPKSH "Higjiena" dhe "Kryqit të Kuq" . Këtu Kryesues kisha pas dëshirë para se të votohet ky rend dite të kemi sqarime nga DPUGJK. Përndryshe kjo pikë më duket si veprim i gatshëm, së pari është deshtë me qenë primare si ta gjejmë një lokacion ku t'i vendosim këto, pastaj t'ju marrim të drejtën e shfrytëzimit. Kështu që si propozim duhet të kemi caktimin e lokacionit ku munde t'i zhvendosim këto dyja përndryshe ku do të veprojnë ato, shtrohet pyetja, ku do ta ketë bazën kur dihet që Komuna e Shtimes dhe fshatrat e kanë një kontratë me Pastërtinë për grumbullimin e mbeturinave, dhe si do të kryhen veprimet e punës ndaj Pastërtisë, ose si propozim kisha kërkuar të shtyhet kjo pikë që të analizohet mirë dhe të mos marrim ndonjë veprim të ngutshëm shkaku që ne mund të krijojmë një kaos në Komunën tonë, sidomos me çështjen e mbeturinave Ky është si propozim imi. Për pikat tjera pajtohem plotësisht, përjashtimisht edhe pikën Raport nga Drejtori i Shëndetësisë kisha kërkuar që të jetë si pikë e rendit të ditës.

**z.Përparim Ramusa;** Faleminderit Kryesues, përshëndetje për Kryetarin Aliu, juve si Kryesues, koleget e Kuvendit, drejtorët, të pranishmit në sallë dhe gjithë qytetarët e Komunës. Paajtohem me parafolësen Adelina që në mbledhjen e kaluar jemi zotuar po thuajse të gjithë që të jetë si pikë e rendit të ditës Raporti i DSHMS-së, ju si Kryesues në bashkëpunim me Kryetarin nuk keni futur në rend dite, gjithashtu ka qenë një zotim më herët që pyetje dhe përgjigje të jetë si pikë e dytë, poashtu pajtohem me propozimin e Reshatit që pika lidhur me caktimin e lokacionit të Pastërtisë të analizohet më mirë dhe të vijë me një rekomandim më të saktë dhe më të qartë. Në këtë format qysh është ky rend i ditës ne jemi kundër.

**z.Rexhep Gashi:** Faleminderit Kryesues, përshëndetje për Kryetarin, për juve si Kryesues, kolegët dhe koleget asamblistë, të gjithë të pranishmit, në veçanti të gjithë qytetarët e Komunës së Shtimes. Kryesues, këto pika të rendit të ditës e dimë që vijnë nga ju dhe Kryetari, por në parim e kemi një plan të punës. Po shoh që disa pika janë të përfshira edhe në plan të punës, por edhe në mbledhjen e kaluar. Mbështes parafolësit që e kërkuan një informatë nga DSHMS dhe ishte zotim i juaji, pikërisht asamblistëve të LDK-së, të cilët u zotuan që në mbledhjen e radhës do ta fusim si pikë të rendit të ditës këtë informatë. Unë nuk e di pse po hezitoni të na sillni një informatë të tillë apo të na vie edhe drejtori i DSHMS-së, pikërisht, fizikisht këtu. Qysh në fillim ky Kuvend na shkoi mbrapsht, gati një vit ishim pa nënkryetar, ndërsa tani na lindën disa probleme te drejtoria e inovacionit, për të cilën Kryetari është zotuar se do ta shuaj qysh në fillim sepse është drejtori e paligjshme dhe do ta shuaj, aty u formuan edhe dy drejtori tjera Drejtoria e Inovacionit përsëri është funksionale, funksionale nuk është sepse për derisa nuk ka buxhet ajo vetëm është drejtori e emëruar nga ju pa buxhet pa asgjë. Mendoj se edhe Drejtoria e Inovacionit, kur po hyjmë në vitin e tretë ska kurrfar informate, ndërsa DSHMS-ja mendojmë se është një drejtori e rëndësishme.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Zotëri Gashi tu kisha lutur fokusohu tek rendi i ditës.

**z.Rexhep Gashi;** Te rendi i ditës jam sepse ka qenë zotim edhe i juaji që të jetë kjo si pikë e rendit të ditës Informata nga DSHMS, ku nga kjo drejtori nuk kemi informatë, drejtori nuk është këtu prezent, pikërisht gati një vit bahen që drejtori është emëruar nga ju, i dimë kalkulimet se qysh ka ardhur deri te ky emërim i drejtorit. Unë i kisha lutur të gjithë asamblistët, pavarësisht a janë pozitë a opozitë a e njihni dikush këtë drejtor dhe a keni qenë ndonjëherë në zyre të tij. Unë mendoj se drejtori asnjëherë në zyre nuk po rri, por as unë personalisht nuk e njoh, edhe po u takuam në korridor, nuk e njoh. Arsyeja është

se kemi shqetësimet e qytetarëve të cilët i ngritin shqetësimet edhe kanë hallet e ndryshme ku këtu përfshihet edhe Mirëqenia Sociale ku nuk mund ta gjejnë në zyre, nuk mund ta takojnë as drejtorin. Informata nuk kemi dhe premtimet ku janë, dhe ja realiteti është se karriga e tij është e zbrazët. Kisha sugjeruar që nëse është në vend pune le të vie të na japë bile një informatë fizikisht, të paktën në qoftë se është në vend pune e nëse nuk është ju lutem na konfirmoni se nuk rri në vend pune dhe arsyeje është se jeni kah e keqpërdorni paranë e taksapaguesve tanë, ku pikërisht paguhet ai, jo prej gjepave por nga taksat e qytetarëve.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Zotëri Gashi të luntem t'i përmbaheni rendit të ditës.

**z.Besnik Seferi;** Faleminderit Kryesues, përshëndetje për juve, për Kryetarin, për drejtorët për kolegët në përgjithësi, për organizatat që janë duke e monitoruar Kuvendin e Komunës, në veçanti përshëndetje për të gjithë qytetarët e Komunës së Shtimes. Sa i përket rendit të ditës, ne si grup parlamentar i LVV-së, pajtohemi me këtë rend dite. Arsyeja e parë duke pas parasysh diskutimet e parafolësve që ishte tema a do të jetë apo të mos jetë pika e katërt në rend dite, nuk i kontribuojmë asgjë keq kësaj çështjeje nëse e diskutojmë si të tillë në fund të marrim vendimin varësisht nga votat e asamblistëve, shumica vendos a të votohet apo jo. E sa i përket çështjes së informatës së DSHMS-së, mendoj se duke u bazuar në planin e punës së Kuvendit është e paraparë që të jetë në muajin e ardhshëm edhe kështu do të jetë besoj edhe nëse jemi ithtar që mos të shkelim procedurat mos t'i shkelim të paktën ta respektojmë një vendim që e kemi marrë paraprakisht, prandaj si të tillë si grup i LVV-së përsëri them që pajtohemi me këtë rend dite ashtu siç na ka ardhur nga ju Kryesues dhe Kryetari i Komunës.

**z.Muhamet Ademaj;** Faleminderit Kryesues, përshëndetje për Kryetarin, anëtarët e Kuvendit, drejtorët dhe gjithë të pranishmit në sallë. Në emër të grupit LDK-AKR e përkrahmi këtë rend dite, vetëm pak dua të lidhem këtu te Rexhep Gashi qe tri vjet po bahen që vazhdimësi po përmendet Drejtoria e Inovacionit, kështu që po me duket i ka ardhur fundi, edhe e tepërt po me duket duke u marrë vetëm me këtë drejtori, duke e ditë që ekzistojnë edhe drejtori tjera në Komunën e Shtimes.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Faleminderit shumë kolegë, nuk pe shoh të arsyeshme me lejua replikë te rendi i ditës zotëri Gashi, vazhdojmë.

**z.Rexhep Gashi;** I nderuar Muhamet drejtorin e inovacionit qysh në ekzekutivin e mëhershëm jam kanë kundra kësaj drejtorie, dhe në fushatë Kryetari Aliu është zotuar se do ta shuaj, edhe arsyeje besueshmërinë e votës së qytetarit dhe votës time, nuk duhet, nuk e di kah është ka adresohet, pikërisht për këtë e ngris si shqetësim, edhe është çështje e palogjikshme mos të themi e pamoralshme e pa llogaritshme drejtoria funksionon pa buxhet, pikërisht e ngris si shqetësim qysh jam duke e ngritur edhe shqetësimin e DSHMS-së që nuk është drejtori fare këtu, dhe nuk na jep asnjë raport, këtu nuk kemi personale asgjë, kemi vetëm sa i përket interesit qytetarë.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Ju kisha lutur ta keni vëmendjen, nuk është mirë që të themi që Drejtoria e Inovacionit nuk ka buxhet, ka buxhet, është bërë risistemimi i vendeve të punës dhe tani janë 11 drejtori në Komunë e Shtimes. Për informatë nëse keni harruar nga mbledhja e kaluar është ndarë aty një buxhet me një organizatë që për momentin nuk po më kujtohet emri dhe 150 nxënës të Komunës së Shtimes do të përfitojnë nga ky projekt trajnime ose kurse të ndryshme, po mos të kish buxhet nuk kish me ndodh kjo. Kështu që e di që se dini se nuk e keni votuar as buxhetin, dhe për ata nuk e dini që ka buxhet. Po ju kisha lutur që kur të hyjmë në rend të ditës të flasim për këto tema, mos ta ekzagjerojmë rendin e ditës. Unë e kisha hedh në votim ashtu siç ka ardhur me nëntë pika dhe siç e prezantova në fillim.

***Kuvendi i Komunës së Shtimes, me 11 vota "Për", me 10 vota "Kundër" dhe me 0 vota "Abstenim" miratoi rendin e ditës.**

**Pika 1**

<u>Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më: 26.02.2024</u>

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi:** Hapi diskutimin për këtë pikë. Po besoj që ky Procesverbal është bërë ashtu siç keni kërkuar dhe pothuajse se çdo fjalë që e keni thënë është e përfshirë, dhe është një material më voluminoz se në të kaluarën.

**z.Reshat Mujota:** Pikërisht, sa i përket Procesverbalit jam kësaj here më i kënaqur me atë djalin që e ka mbajtur procesin, kështu që po i tregoj Idajetit që ja ka shkuar Idajetit për Procesverbal, e respektoj shumë

dhe e faliendoroj shumë, sepse të gjitha ato që i kam diskutuar në Kuvend i kam në Procesverbal të përmendura dhe jam për këtë Procesverbal.
**znj.Albana Podvorica**; Faleminderit Kryesues, përshëndetje për juve, për të gjithë të pranishmit, vetëm kisha kërkuar që drejtorët ose drejtoreshat kur kanë të përgjigjen të na kthejnë përgjigjet me shkrim, për shkak se po duhet t'i përsërit pyetjet edhe mbledhjet e tjera.
***Kuvendi i Komunës së Shtimes, me 19 vota "Për", me 0 vota "Kundër" dhe me vota 2 vota"Abstenim", miratoi Ekstrakt-Procesverbalin nga mbledhja e mbajtur më 26.02.2024.**

Pika 2
Propozim-Vendim për ndërrimin e destinimit të ngastrave në ZK-Davidovc

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Hapi diskutimin për këtë pikë. Sa për informatë për ju që nuk jeni në KPF, e kemi diskutuar këtë pikë, jemi pajtuar unanimisht që kjo pikë e rendit të ditës të kalojë në Kuvend, por paraprakisht do t'i japim fjalën drejtorit të DPIGJK-së zotëri Grejtalb Emini që ta elaborojë këtë pikë dhe nëse keni ndonjë pyetje rreth kësaj çështje mund t'i drejtoni tek zotëri Emini.
**z.Grejtalb Emini, drejtor i DPUGJK;** Faleminderit Kryesues, përshëndetje për të gjithë. Sa i përket pikës së rendit të ditës më lejoni t'ju njoftoj që fshati Davidoc ka bërë kërkesa të kamotshme për ndërrim të destinimit të parcelës komunale e cila gjendet përballë Xhamisë së fshatit. Duke pasur parasysh që fshati Davidoc është zgjeruar në pjesën e majtë të rrugës, kërkesa për zgjerimin e varrezave ka ardhur më shumë se tre apo katër muaj, e kemi përmendur edhe këtu ne Kuvend që duhet patjetër të zgjerohet pjesa e varrezave, varrezat prapë mbesin pronë komunale, mirëpo vetëm i ndërrohet destinimi i tokës nga toka bujqësore në tokë për qëllime jobujqësore, në këtë rast varreza. Duke pasur parasysh që kjo parcelë ka qenë kullosë e klasës së tretë, jemi detyruar që sipas ligjit për tokat bujqësore të marrim pëlqim në Ministri të Bujqësisë, e kemi pëlqimin e Ministrisë së Bujqësisë. Në këtë pjesë përveç varrezave është i ndërtuar edhe Parku ku edhe parkut në këtë seancë do t'ia ndërrojmë destinimin nga toka bujqësore e klasës së tretë në tokë për qëllime jobujqësore, konkretisht në park të fshatit Davidoc. Kështu që kërkoj nga ju që të miratohet ky vendim, sepse është në të mirën e përgjithshme të fshatit Davidoc
**z.Përparim Ramusa;** Drejtor, faleminderit për sqarimet, siç jemi dakorduar edhe në KPF ka qenë kërkesë e kamotshme e banorëve të fshatit Davidoc, të gjitha procedurat ligjore në aspektin e ligjit i keni kaluar dhe e keni marrë pëlqimin nga Ministria e Bujqësisë, që nga toka bujqësore të shndërrohet në tokë jobujqësor e potencove edhe mirë edhe ki atë që prona prape është pronë komunale. Jemi që ky destinim të kalojë edhe për varreza të fshatit edhe për parkun që është ndërtuar.
**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Faleminderit, a ka dikush nga Davidoci që dëshiron të marrë fjalën.
**z.Kadri Emini;** Faleminderit Kryesues, normalisht edhe ne sipas rekomandimit të KPF-së e mbështesim, por kam edhe një rekomandim për DPUGJK-në që menjëherë pas plotfuqishmërisë së këtij Vendimi të obligohet Zyra Kadastrale për të siguruar pikat për shkak se është kërkesë e tyre që me vazhduar edhe disa punime në atë pjesë, e normalisht pa i caktuar pikat nuk ka mundësi me u bë punë për shkak se nuk dihet kufiri saktësisht.
**znj.Zejnije Veliu;** Faleminderit Kryesues, përshëndetje për të gjithë, faleminderit edhe drejtoritë për informacionet, pasi është kërkesë e banorëve të fshatit gjë që është tokë e tyre dhe duhet të menagjohet nga ta kjo hapësirë mendoj që duhet të ketë lloj te destinim. Ne si grup parlamentar e mbështesim këtë, mirëpo në të njëjtën kohë pajtohemi edhe me parafolësin Kadriun, i cili paraqiti disa kërkesa.
**z.Rexhep Gashi;** Përshëndetje për drejtorin, i cili e alaboroi dhe e shpjegoi një punë të mirë, të cilën është bërë. E përgëzoj për aktet ligjore, të cilat i ka nxjerrë pëlqimet, e jo sikur ne rastet e tjera, të cilat kemi kërkuar të nxirren këto pëlqime nga Ministritë dhe nuk janë nxjerrë siç kemi raste të tjerë të cilat janë kthyer nga MAPL-ja, si jo te ligjshme. Kemi disa Vendime këtu, këtu i kam unë, kam kërkuar qasje në dokumente zyrtare ku i kemi shtatë vendime të tilla, dy janë të tilla që unë personalisht kam thënë që jeni duke i pru, janë të kundërligjshme, drejtori i sillte kopi paste të një Udhëzimi Administrativ dhe janë kthyer ato. Unë e përgëzoj për pëlqimin të cilin e ka kërkuar nga Ministria e Bujqësisë, ku jemi për që kjo kërkesë e qytetarëve të miratohet ku e përkrahim.

*** Kuvendi i Komunës së Shtimes, unanimisht miratoi Vendimin për ndërrimin e de stinimit të ngastrave kadastrale në Davidoc.**

Pika 3

Propozim-Vendim për ndryshimin e vendimit të Kuvendit Npi-01-190 për Çerdhen në Petrovë

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Hapi diskutimin për këtë pikë. Saktësisht ka të bëjë me pronën të cilën e kemi ndarë për Qerdhe në fshatin Petrovë dhe atje e kemi ndarë një pjesë prej 7 ari dhe tash MASHTI ka kërkuar që për shkak të ndryshimit të projektit, projekti ka qenë dy kat ku tash është një kat dhe përdhese dhe është zgjeruare, ku afër 7 ari merr vetëm objekti dhe ka kërkuar që kjo parcelë të bëhet 15 ari për shkak të parkingut dhe këndit të lodrave për fëmijët, si informacion duhet me cekë se edhe në KPF-ja këtë pikë e kaë disku këtë pjesë dhe është votuar unanimisht që kjo pikë e rendit të ditës të kalojë sot në Kuvend duke potencuar që të shtohen nga 7 ari në 15 ari.

**znj.Yllka Fejzullahu, drejtoreshë e DKA-së;** Faleminderit Kryesues. Edhe pse Kryesuesi e shpjegoj paka shumë, në fakt ideja është për me rrit hapësirën që ka qenë 7 ari, me rritë edhe për 8 ari, për shkak se nga një raport apo ekspertizë që ka bërë MASHTI ka dalë me një rezultat që numri i fëmijëve në Qerdhen në Petrovë është më i madh se sa është menduar, prandaj hapësira që ka qenë e planifikuar më herët, nuk është e mjaftueshme që duhet të shtohet edhe 8 ari shtesë, për shkak që të mbulohen nevojat e nxënësve që mund të aplikojnë aty e që mund të shkojë numri afër 60, po besoj. Arsyeja që e kemi zgjedh katin përdhesë në vend të katit te dytë është që mos me paraqit rrezik për fëmijët që e vijojnë atë Qerdhe, prandaj kemi vendosur që të jetë kati përdhesë dhe mos të jetë dy kat.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Zotëri Tërshani para se me ta dhënë fjalën kisha kërkuar mirëkuptim që kur të flasin drejtorët.

**z.Hamëz Tërshani;** Faleminderit Kryesues, vërejtja është me vend. Përshëndetje për ty për drejtorët, koleget asamblist dhe gjithë qytetarët e Komunës së Shtimes. Unë e kam një pyetje për drejtoreshën, a jemi tu be hajgare na apo drejtoresha, na keni akuzuar mua Adelinën që nuk e kemi votuar Çerdhen, ku ka pa drejtoresha projekt dy kat Çerdhe, hajgare keni bërë me banoret e fshatit Petrovë, arsyeja është se nuk keni pasur kurrë projekt. D.m.th kurrë nuk kemi pasur pengës në votim ju kujtohet na kemi kërkuar me arrit pajtimin mes banorëve për pjesën aty te varrezave, dikush nuk është pajtuar dikush ka thënë që është në rregull. Absurde a me menduar që fëmijët që shkojnë në Çerdhe me pas Çerdhen dy kat, d.m.th është pa aftësi e juaja që nuk është bërë ende Çerdhja në Petrovë, jam i bindur që edhe sot jemi krejt për me rrit hapësirën për Çerdhe në kushte normale në Kosovë dhe krejt botën janë një kat dhe kat përdhese, kështu që vetëm dua mi reaguar drejtoreshës, prandaj kërkoj falje për atë ndërhyrje, do të thotë projekti për Çerdhe në Petrovë nuk ka ekzistuar kurrë dhe nuk është penguar prej opozitës as prej dikujt tjetër, do të thotë është prej paaftësisë së drejtoreshës dhe ekzekutivit në përgjithësi.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Më fal skam qare pa tu përgjigjur vetem me ta dhënë një informatë, fole për varreza pika e parë edhe qytetarët varrezat janë të familjeve me mbiemër Ademaj ku kam familjar unë. Është e pa vërtetë ajo që e thave ti duhet me fol me banorët, unë jam banor, varrezat janë zotëri të familjarëve të mi, është e pa vërtetë ajo çka thave pika parë. Pika e dytë te projekti për me nis Çerdhen siç ka ndodhur në Godanc është dashtë fillimisht me nda lokacionin ka qen kërkesë e Ministrisë, a është dy kat a një kat, kati përdhes përdoret për fëmijë, ndërsa kati dytë mundem mu përdor për administratë. Mos ma luaj të dijshmin zotëri Tërshani se kati i dytë mundet mu përdor për administratë, jo për fëmijë edhe këtë punë e bëjnë ekspertët jo ti edhe unë edhe ekspertët kanë vendosur kështu, projekti par është dy kat, n dëgjo n dëgjo, ndërsa projekti dytë është kat përdhes edhe kati parë. Ski nevojë me ndezur Çerdhja në fshatin Petrovë do të ndërtohet, lokacioni ka me u ndarë në rregull jena vetëm mos fol të pa vërteta sa i përket varrezave ski nevojë hiq ti me fol për familjarët e varrezave, unë jam familjarë aty. Tjerët nuk janë familjar aty janë uzurpator aty.

Të nderuar qytetarë zotëri Tërshani sot qenka zgjuar ne krah të majtë sot dhe vetëm po ndërhyn kush po fol. Tu kisha lut bërë sjellje shumë të ulëta me drejtoreshën pa mikrofon

**z.Hamëz Tërshani;** Ti nuk ki nevojë me ndërhyrë Kryesues. Ti je njëri prej neve pozicioni yt është spiker, ti vetem ki me udhëheq me ja dhanë fjalën dikujt edhe me ja marr fjalën.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Ju kisha lut të nderuar qytetarë unë nuk jam spiker, fjala spiker është e ulët, unë jam Kryesues i Kuvendit, jam i zgjedhur me votë, fillimisht të qytetarëve pastaj të asamblistëve e jo spiker, po kjo net mbetet në ndërgjegjen tënde ti mendon që jam spiker ashtu vazhdo.
**z.Asllan Beqaj;** Faleminderit Kryesues, i nderua Kryetar, të nderuar drejtorë koleg asamblist. U tha nga parafolësi kolegu Tërshani që nuk ka ekzistuar projekt, nuk u diskutua asnjëherë me qytetarët na jena pajtuar me ata banor atje, janë të pa vërteta prej të pares deri të mbramen, e ki kolegen afër që u kanë bashke me mua në secilën mbledhje me qytetarët dëgjim publik në Petrovë rreth punës së Çerdhes. Projekt ka pas, janë mbajtur dëgjimet publike me banorët e fshatit Petrovë, tri dëgjime publike ose katër herë nëse nuk jam gabim u kanë edhe kolegia zonja Beqaj bashke me mua aty dhe plot banor të fshatit Petrovë. Projekti ka ekzistuar, vendin e këna ndarë bashke me banorët e fshatit Petrovë, nuk është ndarë krye ne veti prej Komunës, tash pse ka ardhur kjo kërkesë prej Ministrisë për mu ndryshua plani i objektit është diçka tjetër nuk ka të bëjë me atë që nuk ka ekzistuar kurrë projekt siç e thatë ju, nuk janë mashtruar banorët e fshatit Petrovë asnjëherë edhe tjetra që është ma e rëndësishmja është penguar direkt prej juve. Si sot jena marr vesh edhe me banorët edhe me kolegen asambliste nesërmen ka ndryshuar komplet, kjo do me than u be në mënyre politike prej juve edhe u penguar direkt prej juve kjo punë, sot ishte duke u ndërtuar si cerdhja e fshatit Godanc, njëjtën mënyrë por u pengu direkt prej juve e tash mos thoni llafe tjera dhe diçka që nuk ekziston, ka pas pengës ne ta din banorët e fshatit Petrovë që ka pas penges direkt prej juve.
**z.Hamëz Tërshani;**Unë vetëm dua me shfrytëzuar drejtën për replikë për atë se ma përmendi emrin Asllani, por nuk dua me komentua Asllanin, është kaq i pa saktë sa që nuk e meriton me pas as replikë.
**z.Asllan Beqaj;** Ky që me tha je i pa saktë, ky a i pa saktë 100 për qind, sepse kurrë nuk ka qenë pjesëmarrës në ato dëgjime publike, dhe ky nuk di asgjë për Petrovën vjen këtu fol sa që thuani në Çerdhe mbahet puna edhe për magjistraturë.
**z.Reshat Mujota;** Faleminderit Kryesues, kërkoj prej asamblistëve të jenë edhe ma konkret edhe ma të saktë dhe ti përmbahen vetëm pikës mos të dalin me luajt popullzimin asnjëra palë. Sa i përket pikës 3 kam edhe pyetje por kam edhe shpjegim për çështjen e Çerdhes. Unë jam qaj që se kam votuar Çerdhen në Petrovë, s'di pse m shefen unë jam kanë kritikë, sepse e kam ditur që e keni pasur gabim, tu e pas gabim sot këna ardhur m e pru vendimin me ndërruar që e keni marr më herët. Kështu që shpjegona qitni në pah , çështjen e varrezave ka pasur shqetësime, nuk a që nuk ka pasur shqetësime. Sot e n dëgjoj Kryesuesin thotë varrezat janë të familjarë ve të mi, në asnjë mbledhje nuk e ka përmend më herët që janë të familjarë të mi. Kam pyetje konkret për drejtorin nuk ka pasur Asllan projekt, dëgjimi publik duhet me shkua me projekt ju po dilni kundra vetvetes po thoni e keni pasur projektin dy kat, tash cilin projekt e keni pru këtu do me thanë ju jeni kundra vendimeve të juaja here e bënë dy kat herë një kat edhe ja huqni total, asnjeri se keni me të drejt çka jeni duke folur. Para qytetarëve keni diskutuar për pozicionin jo për projektin, pozicioni ku ka mu vendos Çerdhja se kemi pasur kontakte na thirrin edhe neve kam qejf me pas informata, për qatë duhet me qen drejtorët prezent që na me ju shtruar pyetje që me p[as të kij artë edhe qytetari për projektet edhe propozimet ti jep edhe Kuvendi edhe qytetari. Tash vetëm sa e votuam një ndërrim de stinimi në Davidoc drejtor çfarë de stinimi ka parcela në Petrovë sepse ndoshta duhet me ndërruar edhe aty se edhe aty ka varreza, duhet me shndërrua në tok për ndërtim, a ka de stinim, edhe kjo duhet mu shqyrtuar. E dyta ju e dini për mes mi prek varrezat janë procesverbalet janë të ingjizuara, kur e kam shtri çështjen a i përfshin varrezat a duhet me tërheq varreza ju keni thënë jo se 7 ari na duhen edhe ato nuk e prekin parcelën ku janë varrezat, tash duhet mi shtuar edhe 8 ari a i prek varrezat prape, a është të njëjtin pozicion, qaty ku ka qenë shtohen edhe 8 ari drejtori vetëm një sqarim mëma dhënë a është çfarë de stinim ka kjo parcelë. Edhe nuk kemi nevojë me diskutuar, tani të ka ardhur kjo me ndërruar Asllani e përfaqëson fshatin Petrovë se është nga ai fshat, por secili asamblist mundem me fol na nuk jemi lokalistë për një fshat këtu na duhet me punua edhe për Petrovë edhe për Recak edhe për Davidocin edhe për gjithë fshatrat e Komunës së Shtimes, për projekte kur bisedohet kështu është ma mirë me ardhur projekti me tu prezantuar në Kuvend me thënë kaq metra na duhen, kaq sipërfaqe kaq tokë na duhet edhe kërkojmë prej Kuvendit me votuar qet parcelë me kaq metra katror. Asnjëherë nuk na kanë ardhur mirë por hajde ta ndajmë një vend ne kotrumqe qatje, hajde ta ndajmë një

vend qikha tjetër, për qeta ti kthen Vendimet MAPL-ja, që shtat i ki, vendime qe këna marr dhe asnjë se ka guximin me përmend a punët vazhdojnë a e dini që është dëm i madh, ju jeni për kallëxim penal, në Pejtershticë për sallon e ki të kthyen prej MAPL-së, atje inspektorati u deshtë me shkua me ja vendos shiritat mos mi mashtruar qytetarët e fshatit Pjetërshticë, mos me lan me ndërtuar, njëjtë e ki në Petrovë që ka mete gërmadhë ajo as shfrytëzim as rrënim, kështu ju duhet me vepruar jo me shkua mi than hajt se na jemi pushtet e veproni, ma se e dëmtoni qytetarin shko tregoj na e ka kthyer MAPL-ja mos ndërto mos shpenzo, nesër vjen një vendim për rrënim aty, si do ti kompensoni ata qytetarë , kush do ta mban atë përgjegjësi. Kështu bahen vendimet të kjarta me projekte me plane, i bini çështjet që t'i kthen MAPL-ja i shfuqizojmë ato vendime le të marrin vesh qytetarët. Ju i keni majtë nëpër fijoka fshehtëe më së shumti kush dëmtohet, dëmtohet qytetari jo Komuna. Merrni vendime paushalle me shumicë votash që nuk e dini as çka jeni duke votuar, këtu e kemi problemin më të madh. Drejtor, a mund të na jepni përgjigjen e destinimit të pronës në fshatin Petrovë, çfarë destinimi ka, a është tokë bujqësore jobujqësore, djerrinë apo e shndërruar për varreza edhe atje që nesër mundet me na dalë edhe një problem ta saktësojmë që çerdhja ndërtohet në këta parcelë a ku destinimi i kësaj toke.

**z.Muhamet Ademaj;** Faleminderit Kryesues, e falim nderoj drejtoreshën për informatën, zotimet e Kryetarit për ndërtimin e çerdhes në fshatin Petrovë po bëhen realitet, ky projekt është i mirëseardhur dhe kërkojmë që të realizohet sa më shpejt. Në emër te grupit LDK-AKR e përkrahim miratimin e Vendimit për ndryshimin e vendimit dhe kërkesën e MASHTI-t që parcela e çerdhes ti ketë 15 ari, më mirë pak fjalë e të bëhen shumë punë.

**znj.Adelina Beqaj;** Faleminderit Kryesues, faleminderit drejtoresh për këto përgjigje të pa sakta që na jep si zakonisht. Mua më vjen keq për dështimet e tuaja të një pas njëshme që janë duke ndodhur, me vjen keq edhe prej Kryetarit që me kanë thënë shumë qytetarë qe po rrejke, perime pot ves a je rrenc a, pot ves Kryetar se me ke akuzuar që se kam votuar çerdhen në Petrovë.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Të lutna kujdes me fjalorin.

**znj.Adelina Beqaj;** Kur ta përmirësoni ju fjalorin tuaj me thoni edhe mua tani s'është problem edhe shkon Kryetari thotë.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Jo nuk lejoj kësi gjuhe ne Kuvend, nuk e kam vetëm për ty, por për të gjithë asambleistët. Unë çdo dit jam ne kontakt me qytetarët, marr vërejtje për kësi lloj gjuhe, nuk ju lejoj me fol me këtë gjuhë, të lutna vazhdoje fjalimin e kujdes për fjalorin. Mos me keqkupto nuk jam duke e thënë personalisht, jo se po dalim krejt jashtë temës pastaj.

**znj.Adelina Beqaj;** Asnjë debat nuk e kam ketë mandat pa me ndërhyrë ti. A ki mundësi me më lan ta përfundoj një here fjalimin tim te lutna dhe net jetë hera e fundit që ti ma ndërpret fjalimin tim, kur ta përfundoj fjalimin mundesh me mi dhënë vërejtjet e tua, nëse jam tu fol gjuhë jo parlamentare jepma vërejtjen ngritëm dal jashtë, ski nevojë ti me më ndërhyrë. Këto janë dështimet e kësaj qeverisje, këto janë dështime që ju keni premtuar që keni me bërë çerdhen ne fshatin Petrovë me një kohë të caktuar qysh e keni bërë për Godancin, për shkak se na ka ardhur kërkesa njëjtën kohë për dy fshatrat, mirëpo për shkak gabimeve tuaja dhe dështimeve tuaja ja që jemi këtu ku jemi. Pra njëri dështim ka qen që ju e keni bërë kërkesën për fshatin Petroviq e jo Petrovë ja ku e kam dokumentin përpara ja u dëshmoj qysh dush, tjetri dështim. Kjo drejtoresha fol pa lidhje se e din që ka dështuar këta e kanë mbuloj për me be mbulimin pse ju ka dështuar kjo çerdhe.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Qëllimi im Doktor Ramusa ishte që mos me ardhë deri këtu, unë thash për krejt ju lutem.

**znj.Adelina Beqaj;** Oj drejtoresh po më vjen keq me të thënë je e dështuar se me i thënë një gruaja je e dështuar, por faktikisht me plot kuptimin e fjalës thamë që je e dështuar në aspektin profesional.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Oj Yllkë, në seancë jena, ju kisha lutur drejtoreshë, ju lutna nëse se ndërpreni fjalën dyjave ju qes jashtë, po, ja dyjave, merrni lexoni rregulloren zonja Beqaj a me lejon të lutna a bënë, ka me ta dhënë minutazhen, a po e kryeni ju unë po rri kryeni pastaj vazhdojmë sinqerisht. O zotëri Tërshani se nuk ishe këtu, unë kërkova që të përdoret gjuha parlamentare jo vetëm prej asamblistëve por prej të gjithëve, thash se e dita që një fjalë atje ka me ndiku dikund tjetër, ti nuk mundesh me leju, kërkon sepse nuk ta lejon as etika morale me e ofenduar. Zotëri Tërshani të lutna nëse ke diçka

ngrite dorën se duke ndërhyrë gjate seancës, ti mund të përdorësh atë gjuhë jashtë në rrugë, ama jo në Kuvend sepse del jashtë, rregullorja të qet, jo unë. E tash edhe të fortin pe luani a, një herë të meçurin tash edhe të fortin. Rregullorja thotë nëse përdoret gjuhë joparlamentare. M fal, po pe di qe je duke u munduar me më qitë prej vetes ama s'mundesh, sinqerisht po me vie keq për gjendjen tënde personale sot, rri more burrë se unë jam me e udhëheqë seancën, nëse s'të rrihet urdhëro dil jasht, kërkoje fjalën merre fjalën. Kërkoj nga regjia që ta mbyll seancën për pak minuta deri sa të qetësohen, mbylle seancën mos të na shohin qytetarët në këtë gjendje. A vazhdojmë besoj që jemi qetësuar pak, po besoj edhe regjia live jemi, vazhdojmë aty ku mbetëm te pika e tretë.
**znj.Adelina Beqaj;** Faleminderit Kryesues po besoj edhe shpresoj se kësaj radhe do ta përfundoj fjalinë pa më ndërprerjen e juaj. E ceka edhe më herët që janë këto dështimet nga ana e kësaj qeverisje për lokacionin e Çerdhes në fshatin Petrovë ku këtu e kam dokumentin me veti ku më është përgjigj Isuf Gashi kam dëshmitar që ja ka bërë sisi Taulant Kelmendi, Bora Shpuza, Arta Balaj edhe Taulant Zhubi ku thuhet që Çerdhja në fshatin Petrovë është bërë në një lokacion të gabuar që është shkruar në fshatin Petroviq dhe jo fshatin Petrovë edhe pasi që fshati Petroviq nuk i ka plotësuar kriteret për nga numër i nxënësve si projekti ju ka dështuar, pastaj keni ardhur sot me një kërkesë tjetër që të rritet hapësira e lokacionit për Çerdhen në fshatin Petrovë, unë kësaj here do ta votojë edhe ju bëjë apel edhe anëtarëve të tjerë të Kuvend që ta votojnë, për shkak që nëse ju si familjar të atyre që janë të varrostë aty e pranoni për neve është puna ma e pakët që mundem me be edhe këto dështimet e juaja është mirë mi mbajt për vete mes me na akuzuar që na s'po jua votojmë projektet e s'po jua votojmë punët e mira, andaj kjo është vetëm një dështim i juaji që sot pas dy viteve na ka ardhur prapo me aprovuar. Uroj që kjo Çerdhe të realizohet që mos të keni dështime apët në këtë aspekt.
**z.Lumni Amrushi;** Atëherë përshëndetje për të gjithë, para se me filluare fjalimin neve na ka ardhur një projekt në email dua me dit vetëm a është ky projekt i parë apo ky që ka mu realizuar tani pastaj të filloj me fjalimin se pastaj merr kaheje tjetër. Ky projekt a ka mu realizuar apo është projekti par apo i dytë. Atëherë nuk e di kush po gënjen këtu Kryesues gjate fjalimit tan thave që nuk është Çerdhja dy katesh, ky projekt është dy kat edhe Asllani e përmendi që ka pas projekt Çerdhja edhe lokacioni par është votuar në muajin qershor të vitit 2022, ndërsa ky projekt është realizuar në fund të nëntorit të atij viti që i bie që keni nis diçka pa projekt e tash po ju del krejt ndryshe, po flas prej dokumenteve që asnjë se kam pas krejt kanë ardhur prej juve ne imell dhe vetëm i këqyra data dhe e mora fjalën për këto dy sqarime me i dhënë për këto dy te pa vërteta që po sillen ne Kuvend. Kati dytë nuk është administratë i paska dy klasa kati i par ose përdhese i paska dy klasa mbase ma konfirmove drejtoresh që do të realizohet ju po dilni në kundërshtim me fjalimet e para që mbajtët, është mirë me na sqaruar jemi për që të realizohet edhe kjo Çerdhe, por mos të hyjmë, Kati dytë nuk është administratë i paska dy klasa kati i par ose përdhese i paska dy klasa mbase ma konfirmove drejtoresh që do të realizohet ju po dilni në kundërshtim me fjalimet e para që mbajtët, është mirë me na sqaruar jemi për që të realizohet edhe kjo erdhe, por mos të hyjmë Kati dytë nuk është administratë i paska dy klasa kati i par ose përdhese i paska dy klasa mbase ma konfirmove drejtoresh që do të realizohet ju po dilni në kundërshtim me fjalimet e para që mbajtët, është mirë me na sqaruar jemi për që të realizohet edhe kjo erdhe, por mos të hyjmë prape me në një konfuz edhe dështon edhe këtë vit Çerdhja për shkak të këtyre ;problemeve të përgjithshme , ato çka kanë qen politike edhe ajo zhurma që ka qenë ka qenë më vend jam për që të s'qërohen të gjitha, mirëpo mos të hyjmë edhe një here e ta dështojmë Çerdhen, faji kryesor sigurisht qe mbetet tek ti drejtoresh edhe te komplet ekzekutivi. prape me në një konfuz edhe dështon edhe këtë vit Çerdhja për shkak të këtyre ;problemeve të përgjithshme , ato çka kanë qen politike edhe ajo zhurma që ka qenë ka qenë më vend jam për që të s'qërohen të gjitha, mirëpo mos të hyjmë edhe një here e ta dështojmë Çerdhen, faji kryesor sigurisht qe mbetet tek ti drejtoresh edhe te komplet ekzekutivi. prape me në një konfuz edhe dështon edhe këtë vit Çerdhja për shkak të këtyre ;problemeve të përgjithshme , ato çka kanë qen politike edhe ajo zhurma që ka qenë ka qenë më vend jam për që të s'qërohen të gjitha, mirëpo mos të hyjmë edhe një here e ta dështojmë Çerdhen, faji kryesor sigurisht qe mbetet tek ti drejtoresh edhe te komplet ekzekutivi.
**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Zotëri Amrushi, unë nuk fola për projektin por dua fillimisht me saktësuar, kur u flit që projekti ka qenë dy katesh thash mundet me qen kati i dytë administratë, thash mundet me

qen nuk e thash që është projekti asnjë kat as dy kat, kati përdhes thash është mirë me u përdor për fëmijë, ndërsa kati dytë mundet me qenë administratë, nuk a çështja e imja ajo se nuk e kam projektuar unë atë.
**z.Lumni Amrushi;** Sigurisht që nuk është as e imja se as unë nuk jam projektues, unë vetem po flas në ata çka po e shoh, unë e di që ajo çka projektohet edhe realizohet, prandaj shqetësimi jem ke ky që po flitet diçka tjetër e në letër është krejt diçka tjetër.
**Kryetari, z.Qemajl Aliu;** Përshëndetje Kryesues, përshëndetje për të gjithë asambleistët, për te gjithë prezent në sallë, për qytetarët që po na ndjekin. Po e shoh që ka nevojë të bëjë një ndërhyrje për sqarim sepse po konfuzen shumë çështjet këtu. Së pari, duhet të dimë që projektet nacionale, që financohen nga Ministritë, nuk i projektojmë ne, nuk bëhet kështu secili me ide në vete jo një kat jo dy kate, jo tre kate. Ju e dini që vitin e kaluar dy Qerdhe kanë qenë të buxhetuara për Shtimen, qerdhja e Godancit edhe qerdhja e Petrovës. Te qerdhja e Godancit e kemi ndarë parcelën, kjo është ndërtuar, kush doni mund të shkoni e ta shihni, tani pritet lyerja shumë shpejt dhe të startojë, me gjasë ne shtator jemi me shpresë që mund të fillojë kurse të njëjtën kohë ka pasur të nis ndërtimi edhe i qerdhes në Petrovë. Si ka shkuar procesi qytetarët e dinë se kush ka votuar kundër, qytetarët e dinë, se kush ka pru njerëz këtu me alibinë "jo e kam varrin e babës e gjyshes", krejt e dinë mos të bëhemi tani këtu se nuk dimë. Zotëri Mujota, mirë e the, ke votuar kundër, mbaje qëndrimin apo përgjegjësinë publike, tani nuk e di pse duhen gjithë këto debate. Janë diku tri projekte nga Ministria, shabllon, qerdhet e vogla qerdhet e mesme, qerdhet e mëdha. Kriteret nuk i përcaktojmë ne as sa katet, si e qysh. Ata vijnë, e bëjnë një studim, e shohin sa popullsi ka, sa fëmijë mund të jenë në atë lokalitet dhe në bazë të numrit të fëmijëve ata e përzgjedhin a duhet me qenë kategori e parë apo e dytë, apo e tretë, nuk vendosim ne, se di pse po shkaktoni konfuzion te këto gjëra, e para, e dyta po na kërkojnë për kategorinë e dytë që është qerdhe e mesme, po na kërkojnë edhe 7 ose 8 ari tokë, ku është problemi këtu, pse tani ne gjithmonë duhet të bëhemi pishtar para ngecjes dhe të bllokadave. Qerdhja në Petrovë do të bëhet, janë paratë, parcela, është konsensusi në fshat, është dhe do të bëhet ndërsa tash nëse dikush zgjedh me votat e popullit për ta ndërprerë ndërtimin e çerdhes,atëherë le ta merr përgjegjësin publike. Qerdhja, po ju zotohem këtu, para të gjithëve se ka me u ba, sepse paret janë në buxhet, projekti është, parcela duhet shtohet dhe ecim tutje. Në qoftë se dikush doni me marrë këtë përgjegjësi unë nuk pe kuptojë pse dikush doni të bëheni edhe arqitekt edhe filozof edhe jurist, shumë e thjesht është se keni votuar para një viti, e keni shtyrë një vit prapa po nuk mund ta ndërpresim, paratë janë të buxhetune, toka është, konsensusi qytetarë është, vullneti jonë është, i ndajmë edhe këto 8 ari edhe ecim tutje. Mos bëni tash këtshu, pikërisht personi që ka qene pishtar i bllokimit të kësaj Qerdhe, sot po doni me reflektu, jo Lagja Pajtimit, jo Petroviqi, krejt qytetarët e dinë nuk mundesh me fshehë dorën e kolegëve tanë edhe kolegëve tu që keni votuar kundër e i lanë Petrovën edhe fëmijët e Petrovës pa Qerdhe, a e kuptoni ky është mëkat, nuk e di sa ju lejon ndërgjegjia njerëzve , ky është mëkat, se jo çdo kush ka kushte sikurse personat në fjalë që janë pishtar të bllokimit me pagu Qerdhe private edhe me dërgu fëmijët në Ferizaj dhe në Prishtinë. Fëmijët e fshatit Petrovë meritojnë me pas Qerdhe edhe Qerdhja do të bëhet. Ju lus votoni edhe mos të bëhemi këtu sikur projektanta, filozofë ku e di unë arqitektë, se nuk merrni vesh në ato sene asnjëri prej juve, asnjëri nuk jeni arqitekt. Projektet nacionale buxhetohen prej Ministrisë, projektohen prej Ministrisë edhe realizohen prej Ministrisë, edhe pikë, edhe nuk e di pse tash duhet gjithë ky konfuzion, është i buxhetuar dhe me emër të zotit brenda tre muajve keni për ta parë seështë vendos gurthemeli i kësaj Qerdhe, bile ju ftoj edhe juve të jeni prezent në një ngjarje kaq të rëndësishme për Komunën e Shtimes.
**z.Lumni Amrushi;** Kryetar fjalimet i ki të mira, mirëpo realiteti është tjetër, nuk e di ti a pe njeh drejtoreshën tanë ajo para dy ditëve ne KPF na tha që Çerdhja ka me qenë përdhes, sot na tha që ka me qenë përdhes, ndërsa projekti ashtu sikur që ti po thua sikur e ka thënë Ministria e kanë kërkuar të mesme , ndërsa fjalimi i drejtoreshës ke që është përdhese, edhe Kryesues që e ki afër tha është përdhes për ata po na duhet hapësire ky ke arsyetimi. Të lutem prandaj të flasim për realitetin është mirë që po bahet kjo Çerdhe, shyqyr që po bahet se nëse duhen edhe 10 ari jo 7 ari thash saksone sot që nesër mes me ardhur edhe një herë me na kërkuar edhe 5 ari tjerë për qeta thash. E sa i përket asaj vonesës unë e pranoj thash pjesën që ka qenë por na e kemi votuar në qershor ndërsa projekti ka filluar në nëntor të projektohet, po flas për projektin që ju na keni dërguar, datat nuk po përputhën edhe ju jeni vonuar me procedurat e juaja

kështu që faji mbetet i përbashkët, shyqyr që po bahet kjo punë edhe jemi për edhe përhajr ju koftë, përhajr na koftë ajo Çerdhe, përhajr ju koftë qytetarëve të fshatit Petrovë, vetëm të jemi realist dhe të flasim me atë që ju jeni duke e punuar jo ne.

**Kryetari, z.Qemajl Aliu;** Zotëri Amrushi, edhe një herë shumë e thjesht bre është, nuk e di pse pi komplikoni gjërat kriter minimal kërkesë që është për Komunën e Shtimes është parcelën prej 7 ari bane 15 ari kaq. Unë nuk e di kujt i shkon për shtati gjithë ky debat gjithë ky konfuzion a është dy kat a një kat a tre at unë po ju them tri kategori janë të çerdheve ajo është zyra e Ministrisë a e zgjedhin një kat apo dy kat me rendi neve po na kërkojnë edhe 8 ari shtesë nuk e di pse na duhet mu be ekspertë, është e buxhetune po na kërkojnë tete ari ja japim edhe vazhdojmë. E bëjnë një kat apo dy kat është shija e tyre ne ta bëjnë sa të donë vetëm ne të na bëjnë Çerdhen me standarde ashtu siç është e buxhetune në rregull është.

**z.Përparim Ramusa;** Nuk është ideja qe na si Kuvend nuk po kemi vullnet mi shtuar edhe 8 ari, tash e deklaroj votën që do të jetë pro, ideja është që ju qe dy vjet i keni rrejt qytetarët e Petrovës na keni rrejt edhe neve këtu e tash ju vjen mërzi pse ju thoni pse po i rreni. Lokacioni për Çerdhe Kryetar a votuar me datë 30.06.2022, ju ka kaluar 21 muaj sipas informatës se drejtoreshës që na e ka pru në KPF që Çerdhja është projektuar dy kat edhe MASHTI e ka kërkuar mu bërë një kat , vet i keni kërkuar 7 ari na ju a kemi votuar vota jem herën e dytë u kanë pro pas qartësimeve që janë bërë për punën e varrezave. Drejtoreshës se El Aliut ju kanë dashtë 21 muaj mi ra ndermen që Çerdhja nuk bënë mu ndërtuar dy kat por duhet një katë, kështu që edhe sipas planit apët dy kat. Pranojeni që Petrovën i keni rrejt qe dy vjet e keni shtyrë Çerdhen na jem për me votuar votën e keni pro vetëm pranoni dështimet.

**z.Rrahman Jakupi;** Faleminderit shumë, të nderuar qytetarë të Komunës së Shtimes, të nderuar kolegë, vitin 2022 me që u diskutua shumë për ketë çështje, po më kujtohet si sot, unë e kam përmend një udhëzues për format dhe standardet e hapësirave të objekteve parashkollore, është bërë në vitin 2018 edhe është bërë shaka në ato momente jo s'po doni me votu, po ju tregoj edhe faqen numër 16 b që shkruan, mirëpo kjo është kulturë e juaja që kur të flet opozita kur të jep ndonjë rekomandim se po mendoni që na këtu vetëm kemi ardhur hajt a din t'i mashtrojmë edhe t'i gënjejmë ata, mi torturu qytetarët e Shtimes, ata janë shumë të interesuar me dit se çka po votohet dhe qysh po votohet. Pse nuk u bë deri tash Qerdhja mbase koka votuar vetëm prej juve pse tani e keni pru këtë punën e 7 arit, pse e keni dërguar atje për Lagje të Pajtimit ose Petroviq pse se keni dërguar për Petrovë, këto janë gabimet e juaja . d.m.th si keni marr për bazë rekomandimet e opozitës atëherë që i kemi dhënë atëherë, as sot nuk i merrni edhe pse shumica e anëtarëve të opozitës u deklaruan se do ta përkrahin këtë projekt, edhe pse është për mu përkrah patjetër. U diskuat aty u tha qe jemi pajtuar me familje tekefundit nuk është tu u ndërtuar për familje por si institucion ndoshta u dashtë me krye ju moti këtë çështje e jo me ardh këtu tash me an treguar jo e keni votuar jo se keni votuar kjo koka votuar në 2022 projekti paska ekzistuar pra kjo u dashtë me u bërë. Se kur po japim na rekomandime si sot që ka nje udhëzues që e ka obligim Kryetari i Komunës Drejtori i Arsimit me lexuar e keni takuar Arbërie Nagavcin disa herë për ketë çështje, ju ka treguar ajo që nuk bahet një herë ju ka treguar gjithçka, por tu dashtë me hedh fajin që spi pi kryeni punët e juaja tu mundu me hedh fajin te opozita por këto nuk ndezin se qytetarët e dinë edhe shumë njerëz i din takimet që bëni. Edhe ju rekomandoj edhe një here që para se me votuar merreni lexon emir udhëzuesin për normat dhe standardet e objekteve parashkollore edhe na e votojmë nuk është ndonjë far problem, për ndryshe në qet formë qysh po na sjellin këto dokumentacione për mua është shumë qesharake nuk jeni tu e sjell para dikujt që ti qite votën me çdo kush pastaj çka bëj unë është punë e imja kjo është çështje e Kuvendit të Komunës. Momentin që e sjellin dokumentacionin tek ne duhet
me pas parasysh se dikush e analizon dhe e shef që është shumë e rëndësishme. Andaj të nderuar koleg dyshoj pra edhe atëherë kam dyshuar që ky projekt mund të zhvillohet, prape do
të ketë kërkesa për këtë projekt unë jam i sigurt, por mbetet ta shohim. Anëtarët e Kuvendit nga opozita u deklaruan lidhur me votimin, ndërsa unë nuk do të deklarohem deri ne momentin e fundit ta shohim si do të veprojë për ketë.

**Z.Grejtalb Emini, drejtor i DPUGJK;** Është çështje e Arsimit, mirëpo propozimet kanë kaluar përmes drejtorisë sime edhe e kam obligim mu përgjigj pas diskutimeve që u bënë lidhur me madhësinë e

lokacionit. Propozimi për Çerdhe në Godanc edhe Petrovë ka ndodh 20.04.2022 propozimi i parë, propozimi i parë për Çerdhe në Godanc kanë qenë 1300 metra katror dhe 1500 metra katror për Çerdhen në Petrovë. Do të thotë herën e parë propozimi ka qen 15 ari, ndërsa Vendimi është votuar me 30.06.2022 me 7 ari, gjate këtyre dy muajve kemi pasur negociata po ju them negociata me banoret e fshatit Petrovë por edhe me Adelinën po ja përmendi emrin për me reduktuar hapësirën e çerdhes në fshatin Petrovë për çështjen e varrezave, dështimi në seancën e parë për çerdhen ka qen për çështjen e varrezave por na prape çerdhen në at parcelë e këna votuar nuk e kemi dërguar ma larg vetëm ja kemi zvogëluar hapësirën njëjtën parcelë ka qen edhe propozimi parë që si ka marr votat për shkak të varrezave do me thënë paskemi gabuar komplet si atëherë që sipas standardeve që po përmend zotëri Jakupi Ministria ka thënë është hapësire e vogël mu ndërtuar çerdhe e kategorisë se mesme e thjesht a merren shikojeni propozimin 20.04.2022 i nënshkrua prej meje e ki 15 ari për çerdhen në Petrovë, e din Adelina e din Asllani çfarë probleme kemi pas me disa banor ku edhe 25 ari mu marr nuk mbërrin te varrezat e lagjes Ademaj ku janë pretendimet se askush nuk e din saktë ku ka varreza në atë lokacion po pretendimet janë te kioska në një qosh të vogël në fshatin Petrovë. Ju lutna mos të bëjmë polemika të pa nevojshme në këtë pjesë, qaty ku këna votuar herën e parë duam me votuar edhe herën e dytë, propozimi paska qenë 15 ari kush se ka pa propozimin ju lutna merrni shikoni materialet e 2022 unë e kam para vetit.

**z.Përparim Ramusa;** Drejtor nuk është faji i asamblistëve pse e kanë votuar me datën 30 qershor , faji është u ekzekutivit je ardhur ke deklaruar që pas mosmarrëveshjeve me banorët për çështje të varrezave 7 ari na mjaftojnë, a ka qen kështu e ke propozuar vet 7 ari herën e dytë po flas edhe ta këna votuar, pranoje që gabimi është i ekzekutivit tash mundohesh me gju fajin edhe te Kuvendi, nuk është e vërtet fajin e ke ekzekutivi për këto shtyrje. Faleminderit Kryesues tu kisha lut qite ne votim se këna me votuar.

**z.Adelina Beqaj;** Faktikisht kemi qenë së bashku në diskutim publik me drejtorin, Asllanin edhe ka pas edhe disa persona tjerë, po dum ju lidh me Përparimin që tha na të pyetëm atë dita edhe qytetaret ishin qaty a janë boll 7 ari për mes me shkel në varreza thave po a është qashtu edhe shkove me 7 ari ta votonim krejt ne rregull, dështimet janë te juaj at tashti ju po dini me thënë shumë e thjeshtë me votuar edhe kaq. Edhe unë tu pas parasysh qeto dështimet qe i ki qetash unë jam tu dyshuar prape qe prape pas dy muajve ki me ardhur me një propozim tjetër për atë çerdhe kështu që mos prit ma meta votuar edhe mos me bir ma kërkesa për atë çerdhe kaq kryeje edhe përfundoje edhe u krye qik jo punë, ty pot drejtohem se për atë drejtoreshën s'di a prek punë me dorë, a banë punë.

**z.Besnik Seferi;** Është një tha je e mirë e një libri shumë zhurmë për asgjë, ne funde m ram po biem dakord që gjithë jemi për që te lëshohet apo ti epet mundësia për aq sa është kërkuar dhe ne fund të m ram gjithë ky diskutim për kurrgjë hiq bash për kurrgjë hiq. Unë sinqerisht po thamë nuk po dua me zgjat por duhet me pasur ti parasysh që mos të përdoren shprehje që secili prej nesh duhet me dhënë llogari. Dhe sa i përket kësaj pike sigurisht edhe ne si grup i LVV-së pajtohemi ashtu siç është ardhur nga drejtoria DKA dhe DPUGJK të vazhdohet si e tillë.

**z.Rexhep Gashi;** Me të vërtet u stërgjatë kjo pikë, kur unë mendoj se nuk është dashtë të stërzgjatet kaq shumë, por u dashtë të jemi pak ma të qartë nga informata e drejtorive dhe pikërisht e Kryetari dhe morëm disa informata nuk ka qenë as në 2022 nuk ka qen kundra asnjë asamblist kundra këtij institucioni por kam qen kundër veprimit se si asht ka shkon ndarja duke i par disa tendenca atje të cilët janë dashur ta kundërshtojmë këta, por veprimet qysh janë ka merren jemi kundër ndërsa kur i kemi marr disa sqarime edhe unë kam qen pro edhe mendoj se ata asamblist qe kanë votuar kundër nuk janë kundër institucioni por veprimeve që janë ka merren. Drejtoreshë me keqardhje por ju nuk keni qen në 2022 nuk po dum et arsyetua atëherë ka qenë Luli drejtorë dhe mendoj se fare pak nuk ka qen hiq në sall, këtë projekt qysh na ke sjell sot nuk na është sjell në 2022 se4 ka qen kërkesa vetëm për ndarje të lokacionit jo projekti siç ka mu be dhe qysh ka mu ndërtuar. Mendoj se të gjithë asamblistët këtë projekt duhet me ju përgëzuar ashtë e th mive ton asht institucion dhe s'besoj që dikush është kundra por besoj që të gjithë janë pro, edhe unë do të jem pikërisht pro këtij propozimi projekti.

**z.Reshat Mujota;**Të them të drejtën nuk dua me marr fjalën por debatet po me nxisin, e dha sqarimin Kryetari me vjen keq që po nxitohen ne fjalime edhe po bini ne afekt që pa u merr me atë çështje po flisni jo ka me qenë kështu ku kështu po devijon komplet pika e rendit të ditës. E tha edhe parafolësi drejtoresha

nuk ka qen në 2022 por mbi të gjitha nuk na ka erdh prej DKA-së absolut çerdhja na ka ardhur prej DPUGJK-së edhe prej propozimit te Kryetarit. E tha Kryetari që e pranoj Mujota që ka qen kundra te jam i sinqertë kundra veprimeve kam qen edhe sot ma ka dëshmuar Vendimi që u marr edhe ndihna krenar, nuk kam votuar kundra kum abstenuar e keni në procesverbal nuk kam dhënë votë për se kam thënë se ky Vendim është i kundërligjshëm edhe po del se tu ka kthyer ky s'po pranohet çerdhja po duhet mi shtuar 8 ari. E pyeta drejtorin kjo me interesoj nëse jem tu e marr sipas vendimeve që po kthehen të paligjshme mos te nguten me marr vendime, të qartësohemi edhe kur te votojmë ta dimë që u krye një punë dhe mos të na vjen prape me ndërruar Vendimin. Çështja e çerdhes në Petrovë ma dha një lloj sqarimi faktikisht me të vërtet janë varreza shumë te vjetra por sa do që të jetë ato janë varreza mua mënyra s'po me pëlqen me qen çerdhja në mesin e varrezave , nuk është çështja e një lagje Ademaj a i prek varrezat, nëse gërmohet qaty po te na dalin eshtra cilat do të jena veprimet e tona si Komunë qeto ti sqarojmë qite ne votim net kalon çerdhja në Petrovë edhe 8 ari shtesë, kjo ka kaluar në mënyrën jo te duhur sa i përket projektit një kat dy kat edhe tre kat tekefundit se në Petrovë i bëjnë vend krejt, shërben ajo edhe për tre kate, ju vini tani thoni se keni votuar, ju keni pas probleme vet keni ra ne desh më këtë mënyre mos me kaluar. Kështu që unë po pres me dal në votim me sqarimet ndoshta e jap votën për hiq si dihet net jetë i sigurt që kjo ka me vazhduar dhe skena me pas telashe me ligjin jemi për.

**z.Asllan Beqaj;** Fjalën e kisha nis me një pyetje çka nëse nuk i kishim pas votat si pozitë sot, qa kish ndodh apët njëjti gabim qysh ka ndodh herën e parë, tu u bazuar në disa fakte që u ngritën deri qetash. Drejtori tha propozimin e këna pru me 15 ari , nëse e nderura Adelina Beqaj e kisha votuar ashtu siç ka ardhur sot çerdhja ish në Petrovë, gabimi është pikërisht te ju zonja Adelina njëjta kërkesë me 15 ari po na vjen sot ne Kuvend, posë se kur ke shkuar te drejtori ke kërkuar me zvogëluar parcelën me be 7 ari ke be gabim  që edhe Komuna e ka hup çerdhen për fshatin Petrovë, ti vet theve më herët drejtorit këna diskutuar, kum ardhur në zyre, ti vet po thua edhe prape vet nuk pe pranon, vetëm dua mu sqaruar te banoret e fshatit Petrovë që çerdhja u pengu edhe nuk u ndërtua dhe e ka një emër një mbiemër. Propozimi ka ardhur 15 Ari ke kërkuar me u be 7 ari tash prape po e voton qeta me 15 ari edhe ka pas vetëm pretendim që ka pas varreza edhe u kanë pengës vetëm politikisht mes mu ndërtuar çerdhja aty në fshatin Petrovë.

**znj.Adelina Beqaj;** I nderuar kushëriri jem Asllan Beqaj atëherë kur e ke votuar çerdhen e fshatit Petrovë si ke pas numrat mos harro ta kam votuar unë edhe e ke kaluar. Kur  a puna te 7 ari qaty jena kanë e din fort mirë mos u mundo me lakuar sene se unë kurrë në zyre te drejtori s'jam kanë thash jena kanë ne lokacion së bashku me drejtorin edhe ti je kanë me mua edhe e kanë këqyr edhe këna thanë 7 ari janë boll, unë jam për ata çerdhe.

**Z.Asllan Beqaj;** As Adnani as profa Muahmet nuk kanë thanë janë në qatë pjesë të parcelës ku është pretenduar që janë varrezat por kanë thënë në qosh të parcelës, varrezat janë shumë më larg lokacionit ku ka mu ndërtuar çerdhja, kum fol edhe kam me fol gjithë.

**znj.Zejnije Veliu;** Kjo çerdhe është investim nga Ministria dhe Ministria e ka bërë projektin ku vetem baza e saj është 700 metra katror, projekti paraprak ka qen 300 metra katror, këto arsyetime drejtoresha na e ka dhënë neve ne mbledhjen e  KPF-së, ka thënë se kjo çerdhe do të jetë e kategorisë se dytë apo të mesme ku do të përfshihen 50 fëmijë dhe kjo çerdhe me këtë aneksin shtesë që po na kërkohet me 8 ari besoj i plotëson gjitha kushtet për me qen çerdhe. Dështime nuk ka ne DKA pse nuk ka dështime, vetëm në këto momente kur jemi ka diskutojmë kamerat e sigurisë janë duke u vendos në shkollën profesionale. Mandej gabimi ka qen te fshati Petroviq që këta po e cekin ka qen gabim teknik nga UNICEFI në vend të fshatit Petrovë na është cek fshati Petroviqë. Mandej po filet shumë e keni rrejt Petrovën kush ma shumë se ju e ka rrejt Petrovën për 22 vjet ju Petrovën e keni par vetëm votë, asnjëherë nuk e keni par investim e keni par vetëm votë tash kur po investohet atje ju po jeni shkaktar për me i penguar ju ne varreza me taksa te qytetarëve e keni bërë trotuarin.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Drejtoresh nëse e ki dokumentin kërkoj me publikuar edhe e di që e ki. Publikoje në rrjetin tënd social ne ta shohin qytetaret.

**z.Rexhep Gashi;** Me të vërtet ja kemi filluar të bëjmë popullzim në këtë pikë, por vërejtjet tek ti Kryesues jam ka i dha, Arsyeja është ti je Kryesues i gjithë Kuvendit të Shtimes. Kryetari është banor i gjithë

banorëve të Komunës së Shtimes, nuk është Kryetar i VV- këtu duhet me qen për të gjithë asamblistët njëjtë, jo dikujt mi thënë ke kaluar prej pikës së rendit të ditës e disave mes me ju thënë me ju thënë fol se nuk ka problem. Këtu ndarje po bëni po del te drejtoria edhe te dështimet e DKA-së. Këtu pat edhe parafolës të tjerë që thanë shyqyr qe i kemi bërë votat, nuk ka votë këtu kur a interes i qytetarit as pozitë as opozitë, kur e bini më projekt edhe jeni konform ligjit të gjithë e votojmë. O votua me 14 vota në vitin 2022 në muajin i 6, ju lutem mos bëni popullzim po kaloni projektet ku janë interes i qytetarëve ju bëni nder edhe qytetarëve edhe Kuvendit. Por mbi të gjitha ti Kryesues duhet të jesh Kryesues i të gjitha subjekteve politike.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Unë jam Kryesues i të gjithëve vetëm më vjen keq na bashkërisht e këna votuar Çerdhen, jam tu e përsërit këtë, dhe nuk mundesh mëmë akuzuar ti pse ja ke dhënë fjalën zonjës Veliu, sepse ajo e ka minutazhen e vet. Unë nuk kërkoj që njëqind për qind që ju mi shkuar për vije pikës së rendit të ditës, ama jo me dal krejt në aut. vetëm po ju kërkoj të kemi mirëkuptim që kur flasim mos ta ndërkrejmë njëri tjetërin. Kuorumin e kemi prej 21 anëtarëve e hedhim në votim këtë pikë.

*** Kuvendi Komunës së Shtimes, me 20 vota "Për", me 0 vota "Kundër" dhe me 1 votë "Abstenim", miratoi Vendimin për ndryshimin e Vendimit NPI 01/190 të datës 26.06.20222 që t'i shtohet edhe 8 ari parcelës së miratuar më herët për Qerdhen në Petrovë.**

Pika 4

Propozim-Vendim për marrjen e të drejtës së shfrytëzimit të paluajtshmerisë NPKSH "Higjiena" dhe "Kryqit të Kuq të Kosovës" në Shtime

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Hapi diskutimin për këtë pikë.

**z.Grejtalb Emini, drejtor i DPUGJK;** Ky propozim Vendim vjen për faktin se ne si qeverisje kemi nënshkruar një Memorandum mirëkuptimi me Ministrin e Punëve të Brendshme për ndërtimin e objektit të ri të Komunës në vlerë 2.5 milion euro. Lokacion nga ne i përcaktuar për ndërtimin e objektit të Komunës është parë pjesë e parcelave ku janë sot Pastërtia dhe Kryqi i Kuq në Zonën Kadastrale në Shtime, përball Shkollës Profesionale. Këto dy vendime, njana është e vitit 2002 njëra është e vitit 2005 të cilat janë vendime të përkohshme të Kuvendit Komunal për shfrytëzim të këtyre parcelave. E kemi një projekt ideor të ndërtimit të Komunës që është i përshtatshëm për qeto dy lokacione, Higjiena i ka 20 ari, ndërsa Kryqi i Kuq i ka 10 ari. Si vazhdimsi e kësaj po ashtu kemi bërë një Kërkesë në Agjencinë e Pyjeve të Kosovës që këtyre dy parcelave me ju bashkangjitur edhe një pjesë tjetër për ndërtimin e objektit të Komunës. Vlen të ceket se Kryqi Kuq asnjëherë nuk e ka shfrytëzuar parcelën që e ka pasur në shfrytëzim ajo nga viti 2005, Kryqi i Kuq aktualisht e shfrytëzon një zyre të administratë komunale, përkatësisht te objekti i Shoqatave të
Dalura nga Lufta. Për objektin e higjienës jemi d akorduar që me gjet një lokacion për me zhvendos në ditët në vazhdim. Jemi ta hapur për me diskutuar me ta për secilën prej lokacioneve që ata kërkojnë edhe nëse janë prona të Ekonomisë Pyjore. Gjithë e dimë që në vitin 2002 kjo parcelë ka qenë në periferi të qytetit tani aty është qendër. Asnjë qytetari nuk i banë nder pa pastërtia që krijohet aty për rreth objektit të Higjienës sidomos kur ka erëra të forta, për shkak se ata e kanë shfrytëzuar edhe për parking por edhe si meni depo të grumbullimit të mbeturinave, kjo është edhe arsyeja që edhe nëse nuk kisha pas projekt për ndërtim të Komunës u deshtë mi be zgjidhje objektit të Pastërtisë me dislokuar nga ai vend me qit di kund tjetër. Vlen të theksohet se tash në atë lokacion është ndërtuar Tregu është në plan mu ndërtuar QKMF-ja është Shkolla Profesionale, është objekti i Policisë, pritet mu ndërtuar edhe objekti i ri i Zjarrfikësve ku do bëhet një qendër me objekte publike për rreth. Faleminderit çdo paqartësi që e keni jemi të gatshëm me ju përgjigjur.

**z.Reshat Mujota;** Faleminderit prej drejtorit për sqarimet, është me të vërtet pjesa aty ku është Higjiena aty jo vetëm aty po komplet fshatrat e krejt Komunën s'kemi qejf mi pas të pa pastra, e sidomos në qytet, por pjesa e marrjes së drejtës së shfrytëzimit nga Higjiena dhe Kryqi i Kuq e thash në fillim të mbledhjes m doket hap i ngutshëm. Është arsyetimi për ndërtimin e objektit të Komunës. Unë mendoj që shumë ma mirë për ndërtimin e objektit të Komunës shumë ma mirë se Komuna duhet të jetë në vend qendror, me Komunën nuk mundemi me luajtur na si me Higjienën masë 4 viteve me thanë jo nuk koka mirë këtu,

qeto veprime nuk janë shumë të mira. Gjatë pjesës së fushatës çdo herë premtim, propozim këna pas që të hiqet qendrën e, jo e këna pas me heq Domin Entin Special premtim me heq dhe gjitha objekte Komunale duke u nis prej Komunës dhe gjitha Institucionet Administrative ti qesim atje. Tani na vjen një parcelë që unë mendoj që absolutisht nuk o plotëson kushtet për ndërtimin e Komunës. Na si Kuvend Komunal nëse e bëjmë çka po me vjen absurde se duhet mu shtri objekti Komunës edhe në fushën e ekspertëve sa shërben në pozitën gjeografike duhet me marr me hap dëgjim publik edhe me qytetarët me marr mendimin e qytetarëve a është pozicion që i kryen shërbimet atje qik jo Komunë. E dyta ne jemi tu e marr një pronë prape që nuk a pronë komunale a pronë shoqërore prape jemi tu marr një që Ministria e Pylltarisë na qet taksa, unë në fund i kam paragjykimet e mia po bëjë pyetje mi jep sqarimet. Çështja ma e rëndësishme Komuna e Shtimes sipas statistikave të fundit i ka 27000 banor, çdo fshat ka kontratë me Pastërtinë, aty bahet grumbullimi i mbeturinave gjitha mbeturinave të fshatrave dhe qytetit. A e dini çka këna bërë na me këtë Kompani jemi aksionar me një pjesë i ndërkrejmë kontratat për mirëmbajtje Komuna i ndërprenë ma vonë thotë edhe parcelën po ta marr pa pasur asnjë mendim se ku do ta pozicionojmë këtë Kompani, aty shërbejnë do punëtor qysh do të kryhen shërbimet ku do ta kenë bazën këta punëtor. Ju në mbledhjet e kaluar j=keni ardhur keni be politik qitu po nxjerrim kamionë donacion për Pastërtinë. Po mënyra ma e mirë nëse na nevojitet na hyn ne funksion për arsyeje ma te mira ai pozicion jam për me heq Higjienën prej aty, po jam me dit vendin ku pe dërgojmë Higjienën ku e ka pozicionin , kështu që mënyra ma e mirë që kjo pikë duhet me dhënë hapësirë edhe me u diskutuar ma gjatë me u shty kjo pikë mos me marr këtë vendim të ngutshëm, me biseduar edhe me për çështjen e Komunës me dëgjim publik edhe me qytetarë me prezantuar plani konkret që Komuna ka me dal këtu, a janë të mendimit edhe qytetarët atje, sot e kemi të copitune na Komunën pasaportat letërnjoftimet shkojnë atje te Gjimnazi këtu disa te shkept qashtu mos te bajna institucione po ta bëjmë një institucion ku i grumbullon të gjitha shërbimet e Komunës. Apo a mjafton ajo parcelë nuk ka me mjaftuar ka mu nevojit parking ka me kan qytetarin i detyruar me shkuar me kerr atje ku do ta ketë parkingun qytetari në njërën an tregu qe qëllon dita e premte mbushet kerre atje qytetarët qysh do ti kryejnë, unë po flas për projektin afatgjatë kur del atje çfarë kaosi do të formojmë. Kështu që propozimi drejtor ma së mirti ka qenë ti me pru lokacionin e pastërtisë ku do del me gjet një pjesë të lokacionit kur do ta transferojmë ku do ti kryejnë veprimet sot ama një sqarim ku kur ta marrim këtë pronë ku do ti kryejnë veprimet. Atëherë ju bini dy propozimet, po jam hajde ja marrim Kryqit të Kuq edhe Pastërtisë me një vendim që këtu me çështjen e numrave bahet që po me vjen keq prej disave që e ngritin dorën shumë lehtë edhe diqysh pa e analizuar edhe po me thotë ekzekutivi po thotë Kryetari ngrite dorën vetëm amin, unë për me be amin këtu nuk jam, unë jam ardhur me punuar edhe me kanë i barabartë për te gjithë pa dallime, këtu disa hala s'pe pe tejkalojnë me dal komplet prej subjektit politik hala janë tu kujtua që vetëm subjekti politik, nuk ka subjekt na jemi asamblistë për gjithë qytetarët, për LDK për PDK-së, Për LVV-së për secilin qytetar na këna me përfaqësuar qitu edhe hajde ti marrim vendimet të mira mos të na vinë me na u kthyer vendimet prape. Nuk pajtona në qet mënyrë, nuk do ta jap vota assesi për këtë rast, tani mos akuzoni jo ski dhënë votë këtu. Dështimet krejt duhet me pas interesin mes me dështuar jo vetëm ekzekutivi por edhe asambleja, kur dështon ekzekutivi ka dështuar komplet Kuvendi Komunal, si gëzona as një dështimi unë, unë i gëzohem kur bëjmë punë të mira po dështimeve nuk i gëzona, dështimet me frustrojnë shumë. Kështu që drejtor tu kisha lutur qet pijë në emër tim personal si kandidat i pavarur pot të them këtë çështje epi hapësirë mos të marrim veprime të ngutshme me votuar, tekefundit shumica ne ta voton kjo a çështje personale por kemi me formuar një kaos, po ju paralajmëroj që keni mi hi në hak Pastërtisë dhe gjithë qytetarëve të Komunës së Shtimes, dhe kur kjo Pastërtia nuk do ti kryej shërbimet, nuk do të shkon mi marr mbeturinat me ata të vilet ka lidh kontratë dhe e paguajnë, paguajnë për shërbimet qe jua bënë Pastërtia.

**z.Përparim Ramusa;** Para vetes i kemi një kërkesë edhe dy vendime, kërkesa e ekzekutivit është që Kompanisë Pastërtia dhe Kryqit të Kuq ti merret e drejta e shfrytëzimit te lokacionit ku në vitin 2002 ku Fehmi Mujota paska qenë Kryetar Kuvendi Komunal me vota unanime ja ka dhënë lokacionin për shfrytëzim të përkohshëm. Vendimin e dyte e kemi të viti 2005 ku Fatmir Rashiti paska qen Kryetar ku Kuvendi me vota unanime ja ka dhënë drejtën e shfrytëzimit të përkohshëm Kryqit të Kuq. Unë mendoj

që parafolësi bajagi mirë i artikuloj, kjo a e pa planifikuar, e pa menduar mirë, edhe mua me bënë me dyshuar që është edhe tendencioze. Qysh mundet Kuvendi Komunal konkretisht ekzekutivi me be një propozim të tillë kur 9.7 % te aksioneve i ka në Pastërtia, qysh mundet 40 punëtor me ju marr e drejta operimit kur ata qe 20 vite operojnë aty, kur gjitha mbeturinat e qytetit tonë dhe fshatrave janë të varura prej ati lokacioni, nuk a çështja vetëm e administratës por është edhe çështja e makinerive, sipas informatave që i kam mbi 80 mijë euro KRM Pastërtia ka bërë investime në atë pronë që ju kanë dashtë për operim të punës, tash vjen ekzekutivi me një propozim brutal të pa imagjinuar mirë thotë t'ju marrim e drejtën e operimit pa e ditur ku pi dislokojmë pa e gjet një alternativ për 40 punëtorë edhe për fatin e mbeturinave të krejt Komunës së Shtimes. Mbledhjen e kaluar ky Kuvend me shumicë votash e ka marr një vendim për themelimin e një ndërmarrje komunale që ka me ja marr disa kompetenca, tash një muaj ma vonë ekzekutivi e bien kërkesën me ja marr edhe drejtën e operimit në atë lokacion. Drejtor po të drejtona ty pasi nuk është Kryetari këtu , nuk është mirë si Drejtor i Urbanizimit me pru kësi propozime pa biseduar me atë menaxhment, a keni biseduar me menaxhementin a ju keni sjell najë alternativ se ku doni mi dislokuar, ku kanë me operua ata, ku kanë mi lan makineritë, mos merrni kësi hapa për shkak te mosmarrëveshjeve që i keni me menxhmentin e kësaj Kompanie, kjo është një hakmarrje klasike që prej avionit shihet. Ju kisha propozuar koleg të nderuar mos bini ne grackën e inateve politike, mos bini në grackën e mosmarrëveshjeve tyre që i kanë në mes veti me menaxhmentin, se fundi fundit aty ka punëtor familjar ton që punojnë, një përkrahje tillë e kisha kërkuar prej Besnik Seferit, jo në atë aspektin që është LVV po në aspektin se ky Kuvend e ka votuar si aksionar për me mbrojtur drejtën e Kompanisë, ka marr votat prej këtij Kuvendi. Unë nuk e di qysh mundet Besnik Seferi me pranuar këtë me përkrah, nuk jam që mes mu dislokuar ajo kompani, por paraprakisht duhet me bërë alternativen. Po ja marrim hi bageri e prish objektin ku shkojnë ata punëtor, a keni menduar për këtë. Ju kisha lut edhe një here koleg asamblistë mos bini në gracka tilla pse po thotë Qmail Aliu ose pse po thotë Grejtalb Emini, nuk është edhe etike nuk është edhe njerëzore kjo çka duam me be na. Unë jam kundër, nuk jam kundër si proces por jam kundër pse mes mu marr vesh me kompaninë nëse gjendet lokacioni i përshtatshëm nëse bini në ujdia jemi për me votuar, pse mes me votuar me nis një objekt të Komunës. Nuk është rendi që e nisni e kam dokumentacionin përball marrëveshja ish be në vitin 2022, sekretaria ma ka dërguar mua një marrëveshje të nënshkruar në 2022 edhe gjithëve detyrimet e MPB-së i zoton mjetet për projektin 2023 – 2025. Që nuk dit me planifikuar edhe këta e që doni me qit në katër kat a në pesë kate sikur çerdhen ajo a tjetër send. Ky memorandum bashkëpunimi është be drejtor në dhjetor të 2022 është vula dhe nënshkrimi i Xhelal Sfeqles dhe Qemail Aliut.

**z.Muhamet Ademaj;** Jemi duke diskutuar rreth zhvendosjes së ndërmarrjes higjiena Shtime. Edhe unë për çdo ti kaloj neper atë rrugë aty afër se punoj në Shkollën Profesionale, unë e di që vendimi kur është marr para 20 vite aty nuk ka pasur asnjë shtëpi por nuk ka qen as Shkolla Profesionale as Policia as Tregu tash që po bëhet, në të ardhmen pritet mu ndërtuar edhe qendra e mjekësisë familjare edhe Komuna asht mirë thash se dy sektorët aty janë zhvilluar tash me pa sektorin privat ato shtëpia të mira që janë ndërtuar edhe me pasur Higjienën afër aty mbeturinat, shpesh herë aty edhe kundërmon nga grumbullimi i mbeturinave asht mirë që ka ardhur ky vendim kjo kërkesë që me zhvendos në një pjesë tjetër të Shtimes. Që u përmend mi lan punëtorët pa punë, kurrkush nuk po thotë qe punëtorët mi lan pa punë aty, por me ja gjet një vend ma të përshtatshëm, ndoshta në periferi të Shtimes ata me krye veprimtarin e vet, kështu që në parim unë e përkrahi këtë vendim.

**z.Hamëz Tërshani;** Për dallim prej parafolësit unë në parim jam kundër edhe e arsyetoj. Unë mendoj që ky vendim është i pa menduar mirë, arsyeja është që sendi parë është vendim tendencioz ndaj Pastërtisë që Përparimi edhe Reshati e artikulunen mirë. Pozicioni është i gabueshëm imagjinoni do me thënë një qytetarë në rrugën Adem Jashari ndërsa Komuna është atje në Belincë në Qestë, neper krejt dynjanë edhe krejt Kosovën Komunat janë në Qendër të qytetit. Tjetra është nuk a lokacioni i siguruar për Pastërtinë nuk është siguruar. Arsyeja tjetër është që është mendim add hoc, nuk është iu menduar në formën e duhur, na u dashtë me diskutuar për një vendim të mëhershëm të gabueshëm për çerdhen. Pajtona me Reshatin që duhet me pas një debat publik për këtë punë, tekefundit objekti Komunës është për qytetarët atyne ju shërben edhe ne ta thonë ata fjalën e tyre nëse janë të pajtimit ata me vendos aty ku është pse jo.

Mirëpo duhet me pas një lokacion me siguruar për Pastërtinë, një debat publik për objektin edhe një studim fizibiliteti ma të mirë, paka shumë ky është mendimi jem. Unë deklarona kundër me këtë propozim.

**z.Rexhep Gashi**; Propozomi i vendimit për marrjen e të drejtës së shfrytëzimit e parcelave Higjienës dhe Kryqit të Kuq, të cilat janë dhënë në vitet paraprake edhe parafolësit e para meje që ngritën si shqetësim, është një shqetësim është hap i gabueshëm apo një hap shumë i shpejtë, këtu kemi një marrëveshje mes MPB-së dhe Komunës së Shtimes për bashkëfinancim dhe realizim të projektit ndërtimit të objektit të Komunës së Shtimes , të cilën detyrimet e Komunës neni 4 thotë Komuna do të zotojë mjetet financiare në projektin nga neni 2 pika 1 dhe 2 sipas kësaj marrëveshje në çdo vit fiskal 2023, 2024 dhe 2025 dhe një kopje të dërguar nga MPB-ja këtu vetëm vitin kalendarik 2023 na ka ikur, këtu është bërë një keq planifikim është qysh në start ku nuk kemi menduar qysh atyre operatorëve të zhvendosen dhe t'ju caktojmë një lokacion, ku na punojnë në bazë të një plani zhvillimor komunal në vitin 2009 ende nuk kemi Plan Zhvillimor Komunal të ri. Me atë Planin e vjetër qysh i kemi punët te ajo parcelë, edhe një shqetësim është nga Kryetari neve në fushat është zotuar se Entin Special do ta zhvendos prej aty dhe pikërisht aty te ndërtohet objekti Komunës, çka ka ndodhur te lokacioni tash pe ndryshojmë lokacionin, për këtë sigurisht do të më jep sqarim Kryetari.

**z.Kadri Emini;** Po besoj se te kjo pikë e rendit të ditës sa i përket heqjes së të drejtës së shfrytëzimit Kryqit të Kuq jemi dakord gjithë për shkak se e njëjta edhe ashtu se ka shfrytëzuar, këta kanë kërkuar edhe prej meje edhe prej anëtarëve tjerë të Kuvendit besoj që me ju gjet një lokacion tjetër të paktën për zyre. Sa i përket Higjienës nuk ka rendësi a ndreqet objekti Komunës apo nuk ndreqet aty, unë mendoj që ajo hapësirë duhet lirohet, nuk duhet lejohet Higjiena me operuar në të njëjtën vend ku është tu operuar, normalisht që na jemi për, njëjtën kohë me ja marr drejtën dhe në ditët në vijim bashke me zyrtaret përgjegjës të Pastërtisë do të merremi shumë që ti gjendet një lokacion tjetër i përshtatshëm edhe i duhur për me operuar në të njëjtën veprimtari. Në kohën kur është dhënë e tha edhe drejtori edhe parafolësit ka qen një hapësirë jashtëzakonisht e mirë për këtë veprimtari, ndërsa sot nuk është për shkak të zgjerimit të qytetit që është bërë edhe në atë pjesë, kështu që unë konsideroj që është e domosdoshme po të njëjtën kohë duke u marr sinqerisht shumë me çështjen e zgjidhjes së saj sepse "Higjiena asht pjesë e jona edhe duhet me ju be zgjidhje, kështu që nuk po e shoh unë të arsyeshme me e zgjatur shumë temën edhe diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës.

**z.Grejtalb Emini, drejtor i DPUGJK;** U diskutuan shumë gjëra rreth objektit të Pastërtisë, po dua mu ndërlidh me disa çështjen, asnjë nga ne nuk tha ka me ju marr e drejta e operimit Pastërtisë, asnjë nga ne nuk tha që mbas këtij vendimi ata kemi mi largu prej aty, nuk është as propozim por edhe ne KPF e kam thënë njëjtin send edhe pe përsërisë ju ftoj gjithë juve në takimet që do ti kemi bashke me Pastërtinë për caktimin e lokacionit më të përshtatshëm për ta. Ky vendim i hap rrugë diskutimeve me Pastërtinë për gjetjen e lokacionit, mbas këtij vendimi sinqerisht mi than krye shefit Kuvendi Komunës ka marr një vendim për dislokimin e Pastërtisë për shkaqe këto që i cekëm edhe në Kuvend, besoj është tendencioze me thënë ku keni mi lan 40 punëtorë, mënyra qysh pe thua Përparim është tendencioze. Parimisht po pajtohemi gjithë që Pastërtia se ka vendin qaty besoj po përveç Hamzës parimisht po pajtohemi gjithë. Na e kemi të nënshkruar një Memorandum Bashkëpunimi me MPB-në, është një projekt ideor që është i punuar që është i përcaktuar edhe parkingu edhe për qytetarë që vinë mu shërbyer në Komunë ku sot për sot as Administrata Komunale nuk ka parking në këtë Objekt ku jemi tani. Sa i përket Planit Zhvillimor që e përmendi Rexha në Plan Zhvillimor ajo pjesë është e destinuar për objekte publike, objekt publik a Komuna Shkolla, Xhamia, tekefundit ky ka qenë vizion i joni që Komuna mu zhvendos në një lokacion tjetër, me këtë vizion na kanë votuar qytetarët, na jemi tu e propozuar qet vizion me quar deri në fund arsye jen që na kanë votuar qytetarët. Nëse me lejoni unë e kam një fotografi si do duket objekti Komunës edhe besoj që shihet edhe një pjesë e parkingut. Edhe një çështje tjetër Hamëz nuk jam prej atyre mos ju hyni këtyre temave. Edhe një çështje tjetër e përmendi Reshati që ato parcela nuk janë parcela Komunale ato parcela ju them se jam te Komunës së Shtimes, pra janë prona komunale nuk janë prona te Pylltarisë, nuk kemi nevojë me be kërkesë në Pylltari zgjerimi oborrit mund të jetë pjesë e Pylltarisë po qeto dy prona janë pjesë komunale. Me vendimet e vitit 2002 dhe vendimet e vitit 2005. Enti Special është në

fazë të projektimit ju ka ndarë lokacioni Enti Special do të dislokohet kjo punë është e kryer Rexh nëse na lejon dërgoja. Besoj që pjesën e projektit mundet edhe kryetari me prezantuar sa i përket Memorandumit Përparim kam qejf me qenë i saktë Memorandumi që e ki në lëndë ka qen gabim i administratës komunale në KPF ta kam prezantuar Memorandumin e vitit 2023 po s kisha pas qejf Rexha me bisedua për Memorandumin që ka qen gabim, tregoj Rexhes.

**z.Rexhep Gashi;** Po mos ta kisha këtë material me të vërtet nuk kisha diskutuar çka ke fol në KPF nuk kam qenë aty edhe nuk e di, unë lidhna te materiali që na keni dërguar, nuk është hera e parë që ju gaboni teknikisht por çdo mbledhje keni gabim teknik, përmirësoni, e keni mbush administratën e keni mbush juristë e keni mbush edhe a pet përsëri po ndodhin gabimet teknike unë po referona ne ato çka na keni sjell, 2023 ka ik pikërisht ju keni bërë gabim teknik a i përmirësoni a si përmirësoni neve nuk na keni sjell dokumentin e përmirësuar.

**z.Përparim Ramusa;** Drejtor faleminderit për sqarimet kogja i kjartë ketë në sqarime po nuk do të thotë kjo për një Memorandum Bashkëpunimi me i lan 40m punëtor pa punë. Nuk ke tendencioze pyetja ime dhe vërejtja ime, sikur ti t ishe ardhur para mbledhjes me alternativ për ata punëtor, me alternativ për atë lokacion atëherë krejt mundemi mi diskutuar, por ti je ardhur pa alternativ, nuk din punëtorët ku kam mu zhvendos nuk e dimë as na kjo është brena jonë. Unë kisha propozuar të shtyhet deri në mbledhjen e radhës, merruni vesh me KRM Pastërtinë edhe bire e votojmë, po jo në këtë qasje arrogante edhe tendencioze. Pse nuk keni biseduar, marrëveshje për ndërtimin e objektit u be me herët, pse nuk keni biseduar KRM Pastërtinë kush ju ka ndal bini procesverbalet edhe ta dimë çfarë marrëveshje keni arritur n ashta jeni takuar në kafe po nuk është bisedë ajo.

**z.Besnik Seferi;** Nuk po dua me përmend emra se mandej tani po krijohen replika e kundër replika. Edhe mua mu dok jashtëzakonisht tendencioze diskutimi paraprak i parafolësit që tha se ku do të mbeten punëtorët 40 punëtor. Assesi nuk mendoj që as ekzekutivi nuk ka interes qe realisht punëtorët të mbesin pa alternativ pa zgjidhje. Ajo pjesë është imazh o keq për banoret e Shtimes e sidomos për ata banor që jetojnë në atë pjesë ku bahet grumbullimi mbeturinave e që është diçka absurde aq ma tepër kur natë pjesë janë duke u ndërtuar shumë objekte komunale të cilat kanë për qëllim apo për të jen në shërbim të gjithë qytetarëve të Komunës së Shtimes. Ka pas diskutime ne seancat e më hershme që është e turpshme qysh bahet grumbullimi i këtyre mbeturinave aty dhe tash sot po dalim te një diskutim tjetër ku thuhet se pse mu be ndërrimi i de stinimit aty. Unë jam pjesë ë aksionareve KRM Pastërtia por nuk jam me shkuar me diskutua për çështje qe janë nën kompetencë të drejtorit dhe drejtorit se DPUGJK-së, edhe këtu po donë mu krijuar një kamuflazhi një far katrahure këtu nuk është tendenca edhe ideja për me e shkatërruar KRM Pastërtinë assesi nuk mendoj pasi kam pas sqarime ma te detajuar me Kryetarin edhe drejtorin kështu që edhe mua mu ka dok absurde mirëpo kërkoj nga Kryetari dhe drejtoria që të bëhet një zgjidhje e lokacionit edhe shumë ma të favorshëm që kjo kompani që me krye punën sa ma mirë edhe sa më adekuate qysh është paraparë. Mos te mundemi me krijuar diskutime pa kurrfarë qëllimi çka ne po kërkojmë edhe çka është që Komuna Shtimes do ta ketë një institucion që do ta ketë një vlerë të punimeve 2.5 milion euro, ky investim nuk është vetëm që do të jetë vetëm për shërbime të qytetarëve apo ekzekutivit por do të jetë në shërbim të gjithë qytetarëve të Komunës së Shtimes dhje aq ma tepër zgjidhja ka mu be edhe do të bahet edhe besoj që ka mu be. E them publikisht prape që duhet mu d akorduar bashkërisht që ta bëjmë një alternativ. N ashta isha pajtuar me diskutimin e parafolësit Reshatit kur tha se n ashta ka qen dashtë mu qit në diskutim publik ndoshta kjo ka qen e mirë që zyrtari ligjor te jetë prezent këtu, por për fat të keq nuk është hera e parë por është hera e dytë e tret ndoshta edhe më shumë që nuk e kemi prezent zyrtarin ligjor këtu, për të cilin unë kërkoj nga administratë pse mes me qenë prezent zyrtari ligjor në mbledhjet e Kuvendit, që më na dhënë sqarimet e detajuara sa i përket kësaj çështje. Edhe grupi parlamentar i LVV jemi për të vazhduar ashtu siç është ardhur dhe është kërkuar.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Sa për sqarim zotëri Seferi te pika 4 ne jemi duke bërë shfuqizim të vendimit, nuk jemi tu e nis nesër Komunën atje a po kupton. Mendohet me u nis Komuna atje, projekti është po na sot jena tu be një shfuqizim të një vendimi kurrgjë tjetër. Çështje tjera edhe lokacioni edhe vendimi edhe krejt vine me radhë.

**z.Asllan Beqaj;** Ky propozim nuk bahet assesi në mënyrë tendencioze, nuk është një pasqyrë e mirë me qenë ajo aty sepse është tu u zhvilluar në atë pjesë qyteti shumë është Shkolla Profesionale e ka edhe shumë objekte tjera që janë aty edhe shtëpitë e banimit janë ofruar shumë afër edhe mendoj që është tu u marr një vendim i mirë dhe i duhur për largimin e Pastërtisë, nuk ndalohet ushtrimi i veprimtarisë assesi, sepse në marrëveshje me menaxhmentin atje do të gjendët një zgjidhje për lokacionin që mu bart makineritë edhe zyrat e KRM
Pastërtisë. Tjetra nuk mendoj që ka mu bllokuar grumbullimi i mbeturinave, do të vazhdoj prape tutje siç ka vazhduar, mendoj që duhet ta përkrahni ketë vendim për shkak që është një vendim shumë i mirë.
**znj.Adelina Beqaj;** Nuk po besoj që ka diçka tendencioze këtu për derisa ne po pajtohemi për këtë lokacion për Higjienën por tash deri sa ti po thua ka mu shfuqizuar një vendim, vendimin po e shfuqizon sot po ku po mbesin punëtorët e Pastërtisë a mundemi mëma dhënë qet përgjigje vëlla se jam ka e kërkoj qet përgjigje, nuk a tu me interesuar kurrgjë tjetër po dua me dit ku janë qeta punëtorë mesi ta shfuqizoni vendimin, ku jeni tu dash mi lan këta punëtorë. Ose tash tjetra ju qe keni themeluar një ndërmarrje tjetër publike a doni me marr punëtor të ri për shkak të politikave tona, hajde jepmani përgjigjen ku doni mi lan ata punëtorë, ose nëse jeni të pajtimit e shtyna këtë por ju se shtyni aq dini vetëm e qoni dorën dhe votoni.
**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Vetëm një sqarim themelimi i ndërmarrjes së re dhe KRM Pastërtisë janë çështje të ndryshme qita duhet me pas parasysh, këta nuk është mirë më thënë Adelina të lutem vetëm Ndërmarrja publike nuk ka të bëjë fare me KRM Pastërtinë ka të bëjë me hapësirat publike që kanë me u be, ajo është vetëm inicim nuk a tu u themeluar ndërmarrja, kështu që mos të përzihen këto.
Çka ndodh dy mandatet tjera na e kemi projektin Shtimja 2030.
**znj.Zejnije Veliu;** Neve këtu po na kërkohet vetëm një shfuqizim Vendimi që është marr nga ky Kuvend në vitin 2002 dhe asgjë tjetër, neve nuk po na kërkohet mi lan punëtorët pa punë. Kisha lutur ekzekutivin që të bëjë zgjidhjen dhe besoj në ekzekutivin që ka me bërë zgjidhjen më të mirë të mundshme për kompaninë Pastërtia, dhe për alokimine kompanisë në atë pjesë. Një projekt 2.5 milion euro të quhet tendencioz mua po më duket plotësisht e pa drejtë. Kemi nevojë për një objekt të ri të Komunës, atë objekt nuk do të thotë që do të gëzojmëvetëm ne si kuvendar apo vetëm ne si ekzekutiv, atëkanë me gëzuar gjithë qytetarët e Shtimes pa dallim bindjeve tyre politike dhe pa dallim të çështjeve tyre sociale, kështu që nuk jemi për me lënë askënd pa punë.
**z.Reshat Mujota;** E n dëgjova Besnikun me vëmendje, e dëgjova zonjën Zejnije me vëmendje, më erdh qudi kur tha Besniku nuk jam kompetent, je kompetent se je bashkë aksionar me 9.7% të aksioneve ti duhet me mbrojt interesin, je ti përgjegjës, është tre anëtarët e komisionit, anëtar i bordit ju jeni këta që i shtyni politikat e "KRM Pastërtisë" dhe jeni në mbrojtje të kësaj kompanie. Te çështja e Zejnijes qysh pi ndryshon kjo po me tmerron, vjen një kërkesë për me shfuqizuar Vendimi e 2002 dhe 2005 edhe më kërkesë të DPUGJK-së për ndërtimin e Komunës kthehenithoni na vetëm jemi tu e shfuqizuar atë se s'jemi duke bërë tjetër send. A po lexon në letra, unë po bazona në dokumente çka po shkruan çka po na vjen, nuk jam duke folur në ajër, jam tu fol me një kërkesë të DPUGJK-së që interesi saj është me ja marr të drejtën e shfrytëzimit KRM Pastërtisë edhe Kryqit të Kuq për me ndërtuar Komunën, unë e di që ju nesër nuk mundeni e ndërtoni se shtëpi private me ndërtuar janë do procedura, ki me ble material janë do punë, mos ta devijojmë debatin. Unë po foli konkret në bazë të dokumenteve çka me vijnë. E thash që në fillim tash është edhe Kryetari prezent se nuk ke kur e parashtrova pyetjen, Kryetari ka premtuar që Komuna me gjitha institucionet përcjellësedo të ndërtohet e kam të faktuar, ka thënë do të ndërtohet të Enti Special. Me pa durim jam tu prit me heq prej aty Entin Special, hala ma keq e kemi Entin Special e dalim te Pastërtia, po ma keq a me pas Entin Special qaty ku e kemi se KRM Pastërtia, shumë ma e dëmshme mbi të gjitha ty 80 a numri i pacienteve në të dy institucionet di kund te 80 shi nëse nuk gaboj, në Entin Special ka staf më shumë se që ka pacientë, është e mirë që marrin paga aty ama Enti Special mënyra ma e mirë. Mos të marrim veprime të ngutshme, të thash drejtor edhe më herët nëse unë i kisha pasur dy vendime para vetes edhe lokacionin ku do që të jetë mi dislokuar KRM Pastërtinë edhe unë kisha thënë mu heqPastërtia prej aty edhe unë them, na krejt jemi për. Nuk pajtoj me fjalën po thoni keni thënë thoni me emra nëse ka thënë Reshti thomëni deri tash na ke lodh tu thanë Pastërtia se ka vendin aty

po mos qitni në ajër fjalë, nuk e ka përmend askush pse Pastërtiavepron aty. Çështja është kërkojë prape që ky Vendim të merret ne 2002 me 22 tetot 2022 e keni bërë një marrëveshje, pse nuk u debatua kjo, pse nuk na ka ardhur këto dokumente ma herët me pas hapësire, vjen koha e mbledhjeve shtatë ditë për para për një dokument të rëndësishëm kemi mundur me qel temën edhe në mbledhjen tjetër, me thënë qet problem e kemi qitu na nevojitet na dajna buxhet me ndërtuar edhe garazhda të veturave tashti e marrim një Vendim hajde me heqkrejt Komunën, pse po shpenzojmë pare koti për garazha mos te investojmë në këtë Komunë, hajde ta votojmë krejt një parcelë tjetër edhe qatje ti qesim. Kryetar, drejtor shtyje pikën për një muaj të sqarohemi mirë hajde me dy vendime, këtë variant e thash edhe më herët unë do të votojë kundër këtij vendimi, si do që të jetë e kanëpërgjegjësin e votës secili për veti, por unë nuk mundem kështu me votuar vetëm me shfuqizuar një vendim dhe me lënë në ajër kompaninë Pastërtia edhe na këtu me ngrit dorën pa dit zgjidhjen e asaj kompanie çka kemi me bërë me te.

**z.Besnik Seferi;** Po me duket edhe diskutimi im që pata që thash nuk kam përgjegjësi, përgjegjësin e mendova në aspektin për mu d akorduar me drejtoret për çështjen çka do të bëhet lidhje me ekzekutivin. Sa i përket përgjegjësisë time unë kam përgjegjësi të plot në aspektin e asaj për të cilën edhe jam i thirret edhe i vendos pikërisht nga ky Kuvend që të jem pjesë e ati komisionit KRM Pastërtisë, edhe nuk e di po me duket pak perime gogja popullzim kur po thuhet se po i mbrojmë të drejtat e punëtorëve ku do ti lëmë punëtorët, pikërisht 20 vite janë be kur KRM Pastërtia ka qenë në gjendje tëmjerueshme te punimit të punëve të cilat i kanë bërë punëtorët e KRM Pastërtisë, nuk kanë pas as doreza, nuk kanë pas asgjë mbi atë që janëdetyruar edhe dorezat prej parave tyre mi blerë, ku në atë kohë kanë marr pagë 200 euro mi ble me qeto, paramendo ti e leje ma s'po flas për mjetet e punës për të cilat janëkanë katastrofa le, deri dje edhe me traktorëkanë bajt mbeturina që do të thotë kaq është menduar për ta. Sa i përket kësaj fatmirësisht e kemi një projekt e kemi nga Gjermania nëse nuk gabojë nga deputet e Gjermanisë PSD-ja e cila do të vjen po në këtë muaj, qe na çka po mendojmë për punëtorët, me ja u lehtësuar punët qe me ardhur një aparaturë një kamion i cili do të ja u lehtësojë punën edhe ma shumë sa që e kanë pasur deri më tash. Pavarësisht kësaj unë jam dakord thjesht të bëhet një zgjidhje deri sa jam përgjegjës gjithsesi Reshat do ti mbrojë të drejtat e punëtorëve dhe assesi nuk kam menduar unë si Besnik Seferi dhe ky ekzekutiv që ata punëtorë të jenë pa punë, pa një lokacion shumë ma të përshtatshëm se sa që ka qenë deri më tani.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;**Ju lutem zotëri Asllan Beqaj dy minuta, ju lutem respektoni kohen.

**z.Asllan Beqaj;** Pak më herët e dëgjova një zë prej opozitës andej një koleges tha nuk e dini as për çka votoni, me votuar për mi hap me ja ndërruar një lokacion hala ma të mirë KRM Pastërtisë, me pru një projekt 2.5 milion në atë vend nuk e di qysh votohet ma mirë, me plot përgjegjësi e jap votën dhe ka me ardhur një projekt shumë i mirë aty, dhe kompanisë do ti bahet vendi edhe ma i mirë se që është aty, i hapet rruga edhe ma e mirë, kështu që përgjegjësin për votën time sa herë e kam dhënë dhe e kam jap në mënyrën ma të drejt të mundshme edhe qysh e kemi theksuar të qytetarët ashtu edhe jena tu e mbajt fjalën. Adelinë tjera herë kur e thua fjalën thuaje pak ma me përgjegjësi, se duhet me mbajt përgjegjësi edhe për çkathuamandej. Nëse keni votuar në të kaluarën në atëmënyrë nuk marr përgjegjësi por tani jemi duke votuar shumë mirë.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Faleminderit zotëri Beqaj, por nuk ke mirë me përmend emrin, replikë zonja Beqaj.

**znj.Adelina Beqaj;** Po me duket se Asllani paska nis mëmandjerë friken se është ka hynë viti i fushatës, kështu frikën që kështu n ashta si politikane jam ma e fort se ti, më shef shumë të fort edhe paske nis me m sulmuar, e di që Kryetari një herë mi ka pas lëshuar këto dyja Sanien dhe Zejnijen po s'ditën këto, mbledhjen e kaluar u pat menduar vetë kësaj here i paska thënë Asllanit, po Asllan po me vjen keq s'mundesh me sulmuar ma ki friken nuk mundemme ta heq friken po mos u frikëso unë jam PDK ti je LVV secili i ka votat e veta e ka elektoratin e vet, sa i përket asaj pjesës që thash nuk e di çka je tu votuar nuk të thash ty i thash asaj koleges tënde afër se ajo ndërhyke në muhabet, qik aq u kanë thjesht me ty nuk pata absolut asgjë por nësedonë me pas nuk është problem.

**z.Asllan Beqaj:** Po më shti me fol prape Adelina, nuk e di a ti më kifriken a din që me shef si politikan ma i mirë a unë ty që nuk t kam pa as konkurrencë, gjë qe edhe në Petrovë jam edhe ma i votuar se ti

shumë herë edhe në çdo vend, kështu që nuk të shohkonkurrencë ty, edhe asnjëherë nuk marr mësim prej teje, bile ti je duke marrë mësim prej meje që duhet mi votuar projektet mos me i ndaluar, kjo është mësim i mirë, këtë mësim jam duke ta dhënë edhe besoj që ki me vazhduar tutje.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi:** Ju lutem, mos e teproni.

**znj.Adelina Beqaj;** Kryesues të lutna vetëm po dua me ju përgjigjur Asllanit, kur kam votuar unë projekte ky nuk e ka ditur as ku është Kuvendi, vetëm qet përgjigje kam, kur unë i kam votuar projektet që qetash qyky që është ulur këtu në këtë Kuvend ky nuk e ka ditur as ku është Kuvendi, qikaq e thjeshtë është.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Ju lutem se nuk jena këtu në darsem, vetëm pak ju lutem se edhe procesmbajtësi po ka problem kështu nuk mundet me ju ndjek juve kështu. Zejnije ju ka përmend emri një minutë e ka pastaj zotëri Ramusa, mos kërkoni replika ma se nuk ka.

**znj.Zejnije Veliu;** Paraprakisht mu përmend emri nga një kolege, mirëpo unë kësaj koleges po dua me ja bërë me dije që na kur vina në seancë nuk kemi nevojë mu shikuar me Kryetarin fare dhe drejtën e votës e kam unë nuk e ka drejtën e votës Kryetari për mëma imponuar mua kanë me votuar. Mirëpo kjo me këtë gjest po tregon se kjo në mandatin e kaluar kjo në këtë far mënyre paska votuar.

**z.Përparim Ramusa;** Asambleistë të nderuar nuk është këtu propozimi qysh po mundoheni e justifikuar për çështjeambient alepo tërhiqet Higjiena prej aty. Pse nuk ju ra ndërmend qe dy vite e gjysmë me heqHigjienën prej aty, po është Vendimi që Kryetari i Komunës ski mundur me mbajte një premtim që ka thënë që Komunën ka me zhvendos në objekt të Entit Special, ski mundur me mbajt atë premtim edhe a tu shikuar me gjete alternativa me ndërtuar një Komunë tjetër e para. E dyta për me Asllanin kemi marr vendime të përbashkëta se Asllani deri frik PDK u kanë, s'mundet me na akuzuar neve pse keni marr Vendime jo të mira nëse janë jo të mira se u kanë pjesë e jona. Sa i përket zonjës Veliu nuk ka marrë vendim kurrë se i ka ndërruar shtatë parti politike: LDK, LDD, AKR, Nisma, Lista Guxo pak ka qenë në PDK tani a në VV, do të thotë nuk ka mundur se ka pas rastin me marr vendime. Te çështja e Besnikut që e potencoj, Besnik ma se e ki dokumentin përpara që në vitin 2002 Komuna u kujdes për KRM Pastërtinë, ja ka ndarë lokacionin i ka ndihmuar në ndërtimin ati objekti ju edhe qatë objekt tani doni me ja marr, do të thotë ti më herët thave nuk keni bërë asgjë , na sa kemi pas mundësi kemi be ja u kemi nda lokacionin, ju kemi ndihmuar në infrastrukturë, kemi lidh kontrata meta, krejt atë punë jo e mjaftueshme që është bërë ju po doni e rrënuar. Unë në këtë version deri sa ta bini alternativen ku mi zhvendos jam kundër.

**z.Rexhep Gashi;** Me të vërtetë po dëgjoj prej disa kolegëvekëtu asamblistë të cilët po thonëpopullzim, nuk pe di unë çka është popullizmi edhe çka bëhet popullizëm këtu kur secili ma i fortë se tjetri është ka del edhe ka i maskon senet edhe diskutimet e veta. Dojnë mu tërheq prej përgjegjësive, nuk asht pa përgjegjësi anëtari i aksionarëve në KRM Pastërtia, gjithë asamblistët janë përgjegjës për atë kompani të cilën operon, kemi pjesëmarrje aty me 9.7% nuk mundemi me thënë se nuk ka doreza aty nuk mundemi me thënë që nuk ka pasur doreza, në vitin e tretë është ende me akuzuar. Mos u viktimizoni bre, pse po viktimizoheni ecni tuboni mangët e këmishës edhe grahni punës, vetëm tu u viktimizuar tu i ndreq kravatat tu qit pallavra këtu, mos bëni ma more kësi far sene ju nëse e keni sekret tregoni e kemi sekret ku do të zhvendosët KRM Pastërtia, po në qoftë se është nuk mundemi me mbajtur sekret qitni në letër thoni këtu kemi vendimin këtu do të kalon kjo, edhe ne do të krenohemi që ju do ti zgjidhni problemin e këtyre punëtorëve por nuk jeni ka e zgjidhni këtë problem, jeni ka ja pështjelloniatyre punëtorëve. Kryesues n dëgjo diskutimet edhe ndërhyrjet deri tani ti nuk je tu dhënë vërejtjedrejtorëve asamblistëve, por mua nuk a telashe se di se kush je edhe çka bënë edhe çka fol , por mbi të gjitha ki një konsideratë se je Kryesues, unë nuk do të them spiker po je Kryesues edhe kur je Kryesues mos diskuto dëgjojë mos tu dëgjoftë nuk a telashe hiq unë e ndali diskutimin e po edhe po ndërhyn a e po nuk e di unë me çka je ka fol unë nuk pe di çka je ka fol edhe për çka je ka fol, në qoftë se fol.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Zotëri Gashi me fal nëse e more, s' kesh ka diskutoj me ty unë edhe një herë po të them kur flisni për qytetarët, unë konsultimet që i bëj janë çështje të mijat.

**z.Rexhep Gashi;** Mos më ndërhyj kur të flas mos më ndërhyj.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Nuk jam tuj të ndërhy, pse po ma përmend emrin, s'di nuk po të kuptoj, nuk jam ka merrem unë me ty, ti po thua Kryesues, ti fol vëlla, e ki mikrofonin, i ki minutat e tu, fol.
**Kryetari, z.Qemajl Aliu;** Faleminderit Kryesues, po konsideroj që duhet të bëjë një ndërhyrje më shumë, për sqarim, sqarim për punëtorët e KRM "Pastërtia", po edhe për të gjithë qytetarët, po pse jo edhe për asambleistët. U thanë shumë gjera këtu, ideja është pse objekti i komunës atje dhe jo këtu ku është, po sepse nuk ka pasur vizion me krijuar hapësira' ju e dini. U shit oborri komunës edhe nuk kanë pasur vizion me e ndal edhe me planifiku tani ku kemi me ndërtuar objektin, nuk është se kjo është zgjidhja jonë primare edhe ne kishim pas dëshirë që në këtë lokacion ku jemi mi pasë më shumë se 30 ari, me e ndërtu objektin e jo me shku atje, po ju e dini pse. Jemi detyruar që edhe në zotimet tona me e mendu lokacionin dikund tjetër, kjo e para. E dyta, ju e dini që objekti i komunës së Shtimes është ndërtuar diku në mes të vitit 80- ta edhe ka qenë montazh, dhe si objekt i tillë lejen e sigurisë e ka diku 25 vite dhe praktikisht ne funksionojmë me një objekt që është jashtë çdo parametri të sigurisë , në kuadër të saj jam shumë i lumtur që kemi gjetur brenda dy viteve të para mbështetje nga Qeveria, këtë rast nga Ministria e Punëve të Brendshme, pjesa e administratës që me u financu një objekt që ka me qenë ndër objektet ma të mira në gjithë territorin e Republikës së Kosovës , domethënë shtëpia e qytetarëve të Komunës së Shtimes ka me qenë simbol, mund edhe t'ju prezantoj më shumë qysh do të duket. Kompania projektuese e ka bërë një objekt që ka me qenë simbol i qytetarëve të Komunës së Shtimes. Tash sa i përket punëtorëve të KRM Pastërtisë, mos mendoni që ja u bani gajlen ma shumë se sa ne atyre, ata janë bashkë qytetarët tanë, ata janë familjar tanë, ata janë qytetarë të nderuar që kujdesen për pastërtinë e qytetit tonë, kështu që ne zotohemi para tyre edhe para gjithë qytetarëve që jo qe do t'ju gjejmë zgjidhjen por do t'u gjejmë zgjidhjen edhe do t'i krijojmë kushte shumë më të mira se që kanë pasur dreri tani. Edhe e fundit, ju e dini që edhe sikur hiq mos të ndërtohej ky objekt aty është vend i papërshtatshëm, në kohën kur është bërë para 22 viteve ,vitin 2002, qyteti ka qenë i centralizua edhe ajo ka qenë periferi por tani ajo kompani edhe sikur të mos ishte ndërtuar objekti i Komunës konsiderojmë dhe shumë nga parafolësit e përmendur që nuk e ka vendin aty. Ne tani jemi duke bërë edhe Planin Zhvillimor Komunal dhe ne do t'i gjejmë një hapësirë ku edhe Pastërtia do të operon në kushte ma të mira edhe qytetarët nuk kanë nevojë si me thënë në derë të shtëpis me pas nje lokacion ku kundërmon nga mbeturinat, kështu që edhe një herë ju kërkojë ta mbështetni ktë shfuqizim të këtij vendimi dhe të shkojmër tutje.
**z.Hamëz Tërshani;** Më bëni përshtypje Kryetar nëse të kam n dëgjuar mirë, është shit oborri Komunës është privatizuar, vetëm pak qysh ka mundësi me u privatizuar, kush e ka privatizuar, kush e ka përfituar, na e kemi vetëm përball një objekt që u ndërtuar në masa të dhunshme ku u ndërtuar diçka tjetër afër Komunës, unë po kërkojë sqarim është Kryetar Komune është ligjërishtma i informuar se unë mua më bëri përshtypje kjodhe po dua me pasur informata ma shumë. Po dua me përmbyll muhabetin e më hershëm se ti nuk ishe Kryetar absolutishtkurrkush nuk është kundër me largu Pastërtinë të paktën unë personalisht nuk jam kundër me largu Pastërtinë prej aty. Krejt koleget çka kemi folur janë të pajtimit që me be zgjidhje parapraksht para se me i marr vendimet. Në momentin që na e shfuqizojmë sot vendimin do me thënë ajo Pastërtia atje qata punëtorë atje janëjashtëligjshëm tu ndej në atë objekt, sa ka mu kanë periudha tranzitore që ata kanë drejt me ndenjur më shumë. Na jemi duke kërkuar informacione asnjëri prej neve nuk e tha që jemi kundra dislokimit të KRM Pastërtisë.
**Kryetari, z.Qemajl Aliu;** Edhe njëherë, se ka mundësi këtu jemi edhe në muajin e rahmetit, të Ramazanit, dhe mund të keqkuptohet si konfuze kjo çështje. Ideja është që në kufi të oborrit të Komunës është privatizuar një parcelë e cila do të ishte fantastike ose dy parcela që janë dikund mbi 30 ari, që sikur qeverisja e kaluar ta kishte vetëdijen shtetërore edhe nacionale nuk ka pasur nevojë me pagu sikurse privati me 100% ,por ju e dini që me 20 % të vlerës që është thjeshtë pagesa ndaj punëtorëve ka mundur të bëhet aset i Komunës edhe të ndërtohet aty, por ka pas mungesë vizioni edhe ka pasur halle tjera dhe jo halle të interesit të përgjithshëm, kjo ishte ideja, është shitur te privati edhe ka mundur mu shit te Komuna ku na edhe sot s'kishim pas nevojë me lëvizë lokacionin, prandaj unë desha të them që vetëdija ka munguar, kjo vetëdije shtetërore dhe tani prandaj ne jemi këtu ku jemi, nuk mund tëndërtosh një objekt 2500 m² 2.5 milion euro një vend ku s'mund të ndërtohet as një kotec.

**z.Rrahman Jakupi;** Kemi vizon, nuk kanë pasur vizon këto nuk qëndrojnë absolut zero janë. Sa i përket kë ti vendimi për te cilin sot ne po diskutojmë unë mendoj që pikërisht ju jeni ata që nuk keni vizion, nuk keni vizion me parashikuar se ky vendim mund të jetë i kundërligjshme edhe jo domosdoshmërish të nëse e merrni këtë vendim mundet me qenë i kundërligjshëm që unë mendoj ky është mendim i imi personal edhe mandej çka do të bëni cili do të jetë vizioni juaj nëse kthehet e kundërligjshme. Edhe kjo qeverisje e de shtune gjitha dështimet si në nivel qendror ashtu dhe në nivel lokale kanë arsyetimin qeverisjet e kaluar. Ata ju ka ardhur momenti qe tri vjet i keni bërë qeverisje në nivel qendror edhe ma shumë nuk jeni në gjendje me zgjidh një telashe ose një problematik që ju del përpara, po problemi qëndron me atë Sfekllën a Sfeqla qysh e pat emrin se s'po ja qëlloj. 2022 u nënshkruar marrëveshja sot e kanë sjell këtu edhe a di çkathonëvotoni ju kita tani na atyre ja u bëjmë qarën me një paragraf nëse e keni lexuar dikush thotë Komuna e Shtimes si subjekt publik nuk posedon paluajtshme ri e cila evidentohet në emër të Komunës që i plotëson kushtet për ndërtimin e objektit të ri të Administratës së Komunës së Shtimes. Nëse s'paska paluajtshme ri për Komunën qysh ka për KRM Pastërtinë. Tjetër në të gjitha vendet e zhvilluara institucioni publik sidomos i Komunës rri në qendër ku qytetarët kanë qasje ma te lehtëkëtu me qenë një shesh modern, ku Planin Zhvillimor Komunal nuk keni arritur me bërë ende, katër vjet i keni bërë edhe s'po mundemi me bërë. Nuk ka qenë prioritet objekti administratë komunale ku duhetqeveritaret akomodohen aty pinë kafe por për neve ka qen qytetari me prioritet në qeverisje punohet me prioritete nuk punohet vetëm po me teket apët ja ke huq ke thënë ka me dërguar te Enti special gjithçka objektet komunale, i ki njerëzit që ta dëshmojnë i ki diskutimet publike i ke dhënë nëpër media por ke harrua tani se i ke tjetërsuar, unë gëzona se na mbesin neve në mandatin e ardhshëm mi vazhduar edhe kështu që e shihni këta, por është shqetësuese po gëzona se a më pëlqejnë a s mepëlqejnë tani ajo është diskutabile ajo çështja a pe kupton shija është tjetër problematikpor për neve nuk ka qen prioritet do me thënë objektet luksoze për qeveritaret dhe për zyrtarët por ka qenë Shtepia e Kulturë, Palestra Sportive, Muzeu, Shkollat gjitha ato, mandej në fund kemi pas mundësin me ndërtuar edhe do ta ndërtojmë me siguri në të ardhmen por jo me gënjyer kështu. Edhe po ju paralajmëroj që mundet të jetë edhe vepër penale ky a mendimi i jemi se në Plan Zhvillimor Komunal qaj qe i ka skaduar mandati është ekziston është dokument valid deri sa të votohet tjetri, kështu që ju jeni tu ja ndryshuar de stinimin edhe madje mundeni mu ballafaquar me pasoja, kështu ju kam thënë edhe për çerdhe, thosha ekziston një udhëzim administrativ për ndërtimin e objekteve parashkollore 2017 faqe 6 e tash merreni lexoni procesverbalin i keni videot tani fatmirësisht. Thoshit opozita opozita jo opozita ka profesionalizëm ka vizion i ka të gjitha por ju mungon juve ajo çka e ka opozita.

**z.Përparim Ramusa;** Faleminderit Kryesues me të drejte je tu ma dhënë fjalën edhe të përgëzoj që po ma jep fjalën me të drejt pe zbaton rregulloren. N dëgjo qyky ekzekutiv qaq shumë a tu thënë të pa vërteta, po perimes'pogjejmë kohë me ja shkaporit na, pak ma herët Kryetari vet e tha oborri i Komunës tha u shit, mbas dy minutave duel e demantoj tha nuk u shit. Qytetarë të nderuar a tu dezinformuar, prona e oborrit të Komunës kurrë s'është shit as nuk privatizuar, afër Komunës a privatizuar një objekt që ka qen i AKP-së, nuk ka pasur lidhje kjo me Komunë.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Po e hedhim në votim, atëherë pas gjitha diskutimeve vazhdojmë me votim ***Kuvendi i Komunës së Shtimes, me 11 vota "Për", me 10 vota "Kundër" dhe me vota 0 vota "Abstenim", miratoi Vendim për marrjen e të drejtës së shfrytëzimit të paluajtshmerisë NPKSH "Higjiena" dhe "Kryqit të Kuq të Kosovës" në Shtime.**

**Pika 5**

<u>Pasqyrat Financiare për vitin 2023</u>

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Hapi diskutimin për këtë pikë. Ja japim fjalën zonjës

**z.Kimete Ukaj, ZKF;** Si temë apo si pikë është edhe pasqyratfinanciarepër vitin 2023. Përmes kësaj shkrese po ju dorëzojmë Raportin Vjetor Financiar për vitin 2023, i cili është përgaditur sipas Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë 03/L-048 dhe 03/L-221, si dhe Rregulloret e MFPT-së për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore. Buxheti Fillestar i Komunës se Shtimes ka qene 8,756,040 € ndërsa buxheti Final ka qene 9,806,696.14 €, Kjo rritje ka qene si rezultat nga

kompensimi për zbatimin e ligjit te pagave për zyrtaret publik ne shumen prej 696,604.04 € sipas Vendimit te Qeverise se Republikës se Kosovës Nr. 34/180 te datës 27.12.2023 dhe barta e te hyrave vetanake nga viti 2022 ne vitin 2023 shuma prej 352,849.20 € si dhe donacionet ne vitin 2023 ne shumen prej1,202.90 €. Buxheti final i alokuar dhe i realizuar për vitin 2023 ka qene i shpërndarë ne 5 kategori ekonomike. Paga dhe shtesa - buxheti final 5,296,644.94 ndërsa Realizimi 5,295,789.04 € ose 99.98 %. Mallra dhe shërbime - buxheti final 1,308,984.20 ndërsa Realizimi 1,190,015.43 € ose 90.91 %. Shpenzime komunale - buxheti final 300,000.00 ndërsa Realizimi 252,649.11 € ose 84.22 %. Subvencione dhe transfere - buxheti final 350,000.00 ndërsa Realizimi 313,058.59 € ose 88.19 %. Investime kapitale - buxheti final 2,546,606.00 ndërsa Realizimi 2,324,884.93 € ose 91.31 %. Ne kuadër te realizimit te buxhetit nga Thesari janë ekzekutuar 511,946.39 € për vendimet gjyqësore edhe atë neper këto kategori ekonomike. Paga dhe shtesa – 254,559.21 €. Mallra dhe shërbime – 43,549.76 €. Shpenzime komunale -30,775.92 €. Subvencione dhe transfere – 16,810.59 €. Investime kapitale – 166,250.94 €. Sa i përket obligimeve Komuna e Shtimes vitin 2023 e përmbyll me 122,546.87 € ndërsa sa i përket detyrimeve kontingjentejanë 665,339.75 € ( paga 604,464.27 € dhe shpenzime kapitale 60,875.48 € ) ku pothuajse e gjithë kjo shume rezulton si rezultat i kontratës kolektive përpunëtorët e arsimit dhe shëndetësisë. Pasuritë kapitale me vlerë mbi 1000 € janë: Gjithsej pasuria kapitale ne vlere mbi 1000 € përKomunën e Shtimes sipas regjistrave kontabël me 31.12.2023 ka qene 54,901,199.93 € nga to: Ndërtesa - 9,061,827.22 €. Toka 28,032,061.05 €. Pajisjet196,463.50 €. Infrastruktura 16,631,580.99 €. Makineria 917.78 €. Automjetet 33,392.55 €. Te tjera 845,683.84 €. Ndërsa sa i përketpasurisë jo kapitale me vlere nen 1000 € janëgjithsej 359,811.10 € kryesisht janëPajisje dhe Mobile. Sa i përket Të hyrave Vetanake nga viti 2022 ne vitin 2023 janë bartur 352,849.20 €. Te hyrat e pranuara apo grumbulluara gjate vitit 2023 kane qene 1,035,923.34 €. Te Shpenzuara ne vitin 2023 ka qene 760,019.48 €. Ndërsa bilanci për bartje për vitin 2024 është 628,753.06 €. Stoqet me 31.12.2023 sipas raportit te E – Pasurisë kane qen 46,765.78 €. Ndërsa sa i përket numrit te punësuarve sipas listës se pagave ne fund te vitit 2023 ka qene 689 te punësuar (ndërsa sipas ligjit të buxhetit numri i te punësuarveështë i lejuar 711 ) për më shumë ku zyrtarja shpjegoi dhe elaboroji në pika të shkurta këto tabela (Lexo Dokumentin).
**znj.Muhamet Ademaj;** E falim nderoj zyrtaren e lartë për financa zonjën Ferati për raportin. Ky raport ofron informata të mjaftueshme për tërë buxhetin e shpenzuar gjatë viti 2023, ku shihet qartë se buxheti është realizuar sipas planifikimit. Si sukses i këtij buxheti është rritja e të hyrave vetanake. Unë mendoj se janë duke u menaxhuar mirë paraja publike. E kam një pyejtje për zyrtaren e lartë financiare: sa janë të hyrat nga bizneset që shfrytëzojnë hapësirat publike.
**z.Përparim Ramusa;** Faleminderit Kimete për sqarimet. Kimete kam nja dy pyetje; pyetja e parë është drejtori ne KPF ma dha sqarime se di kund mbi 500 mijë euro ju kanë marr Komunës për vendime gjyqësore, a me planifikim buxhetor për 2023 nuk i keni bërë e këtu ekzekutivi del e proklamon thotë gjitha projektet edhe gjitha punët që i kemi planifikuar mi krye i kemi realizuar. Ka kanë mundur mi marr ato pare ata edhe i kanë marr 500 mijë euro prej thesarit të Komunës edhe ekzekutivi reklamon thotë ne punët i kemi kryere para. E dyta nja dy sqarime se s'pekuptojmë se këto janë më shifra, pagesë Lumturije Ademi 999 euro dreka zyrtare , me najë sqaruar pak, drek zyrtare Apollonia Ferizaj 340 euro, qeto tri përgjigje nëse ki mundësi me najë dhënë. Edhe nëse ka mundësi me ditë cilat projekte kanë jetë pa realizuar tu marr parasysh që procedurat ligjore janëkanë marrë Komunës mbi gjysmë milioni. Kryetari i Komunës ka premtuar që në fushatë që në vitin e parë kontratën kolektive do ta përmbylli do ti bëjë pagesat, asnjë pagesë se ke bërë e tani janë tu ti marr paret me gjyq krejt.
**z.Reshat Mujota;** Faleminderit prej zonjës Ferati për raportin, çështja faktikisht e foli parafolësiçka me ka bërë përshtypje që shumë lëndë të humbura në gjykatë, kështu që po na bie që në dy anët na jemi dëmtuar që na vet i dërgojmë në gjykatë dhe vet e humbim lëndën, këtu është dëmi ma i madhi, shtrohet pyetja pse kanë shkuar në gjykatë këto kur e ke ditur që me të drejtë e kanë kërkesën e këtyre mjeteve dhe shpenzimet te derivatet di kund janë derivate shpenzuese të naftës di kund shkruhet vetëm derivate do me thënë janë gjithëpërfshirës a del p.sh për gjeneratorë derivatet, a pe din shpenzimet për derivate a hyn vetëm derivatet apo janë edhe riparimet se te pjesa e veturave tani i kemi riparimet, këtu nëse kemi shpenzim të derivateve a ka edhe riparime te pjesa e këtyre sektorëve. Çështja tjetër te shpenzimet gjithë

shpenzimet kapital që bahet dhe shpenzimet që bëhet nëpër administratë dhe drejtorit, dua me ndërlidh një çështje që dikush a ka rren këtu po nuk pe zëmë gënjeshtarin qata po kam qejf me zënë . Drejtori tha Drejtoria e Inovacionit ka shpenzim, po qitu në buxhet në raport të buxhetit financiar të ndara për secilin sektor në kategorinë prokurim në administratë d.m.th këtu na bien që nuk ka buxhet, a pe din nuk ka pas buxhet kurrë na e dimë këtë po bëjmë filma këtu po rren po rren ka buxhet po kjo nuk ka buxhet. Po ta bëjë pyetjen si zyrtare financiare nëse ka buxhet se unë e di nuk ka edhe krejt e dinë edhe vet këta që thonë ka buxhete dinë që nuk ka buxhetpo marrëveshjakoalicionit me mbajt këtë drejtori ajo a krejt diçka tjetër, është çështje e numrave ku edhe nëse ekziston si drejtori a konflikt interesi po të jetë ai drejtor apo ky drejtor kështu. Kam pyetje konkrete sa ka shpenzuar Drejtoria e Inovacionit paga nga të cilat i paguan punëtorët, nga cili sektor del që mos mi hy, se unë ka mi hy edhe me qasje në dokumente zyrtare ka me demonstruar këtë, po dua me dit si zyrtare financiare je një profesioniste mos te flas unë me politika po dua në anën profesionale mëma dhënë sqarimet për te Inovacioni edhe të çështja e derivateve edhe te gjykatat, qeto pse ndodhi kjo që na tani edhe gjykatën me paguar si lëndë të humbura edhe plus shpenzimet plus obligimet që i kemi pasur për ti dhënë pse shkuan në gjykatë këto.

**z.Rexhep Gashi;** E falim nderoj zyrtaren financiare e cila e alaborojë një dokument të tillë, me të vërtetë ky dokument unë çdo herë thirrna në shtylla dhe kolona shumë mirë a i rregulluar, por te shpenzimet dhe keqpërdorimetjashtëzakonisht. Unë çdo herë kam qenë kritik në legjislativet e më hershme por edhe te ky është gati, mos të themi i përafërte por edhe në disa po ja kalojnë, arsyeja pse po ja kalojnë se ne kemi bërë kritik, duhet të definohen disa shpenzime, këtu unë po hasi përsëri si nuk janë definuar, shërbime konkrete tjera, të lutem çka do të thotë shërbime konkrete tjera kur e kemi të njëjtin veprim e kanë pas edhe ekzekutivi i ma hershëm kur ne e kemi ngritur si shqetësim pse si keni definuar tash ju njëjtat veprime jeni tu i bërë. Te keqpërdorimet mendojë nuk do thirrem si keqpërdorim por si shpenzim 7200 euro ngrohje qendrore, kur ne e dimë çfarë kohe ka qenë tani, qa ka rezerva të naftës për ngrohej qendrore a çfarë ka ndodhur, derivate për vetura 3015 euro, mendoj se këtu në mbledhjen paraprake ju u thirrët se disa pi përdorin veturat private s'po kanë automjete, ndërsa këtu vinë kogja shumë si shpenzime i keni. Sa i përket parafolësve e ngritën një shqetësim të cilin e ka kaluar në shumë e madhe ebuxhetit në gjykata, ju lutem pse nuk ju kemi ndenjur gati, na e dimë se nuk i keni trashëguar këto borxhe prej ekzekutivit të gjitha, nuk mundem me thënë që si keni disa po gjitha jo edhe këto tri vitet juaja kanë lindur pse pe presim me kaluar këto nëpërmes gjykatave dhe në mes përmbaruesve, ku e dimë se edhe përmbaruesit edhe gjykata e kanë një koste të shpenzimeve të cilat faturohen nga taksat e qytetarëve. Unë dëgjova disa e ngritënedhe më erdh mirë te ngritja e investimeve kapitale duhet ti falim nderojmë qytetarët jo menaxherët, qytetarët qe po ju rrinë gati pagesave, po a ka rritje ka rritje a u rrit shuma po pse u rrit shuma se pikërisht kemi ndikuar edhe te gjepat e qytetarëve e kemi rritur vlerën e tatimit në pronë kur u rrit vlera e tatimit në pronë rritet edhe grumbullimi i inkasimit edhe mendoj se nuk a bash për mu krenuar me thënë se u rrit, u rrit por e kemi dëmtuar buxhetin gjepin e qytetarëve, gjepin e qytetarit e kemi dëmtuar me ngritjen e vlerës së pronës, nuk është për mu krenuar, këto dy sqarime sa i ngrita të lutem mi jep zonja Kimete.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Faleminderit, vetëm duadiçka te zotëri Gashi, po nja 5 a 6 herë e përmende termin keqpërdorim i buxhetit, keqpërdorim i buxhetit kjo është akuzë e rëndë nëse e kupton drejtë është akuzë e rëndë me thënë , ki drejtë por ski drejt me thënë për diçka që se dinë duhesh me dit diçka për me thënë se kjo është akuzë drejtë ekzekutivit, nuk mundesh me thënë për çdopyetje që donë me bo keqpërdorim, nuk thave dyshoj zotëri Gashi, jo është term i rëndë po duhesh me qenë i vetëdijshëm kur flet para qytetarëve.

**Kryetari, z.Qemajl Aliu;** Sinqerisht ka vite, ka muaj që çdo fjalim që e nis e nis keqpërdorim keqpërdorim, unë e di që ty të përzihen nocionet edhe s din me be dallime kështu çkatë vjen llaba lluba flet. Po fjala keqpërdorim a saktësim zotëri e kupton është akuzë, kështu që kujdes se na tmerrove me këto keqpërdorime, sinqerisht mbaj përgjegjësi për fjalën publike, keqpërdorim çdo të treten fjali keqpërdorim, a e kupton çka do me thënë keqpërdorim. Nëse ka keqpërdorim zotëri qe ku është prokuroria edhe qoji atje edhe na jemi të interesuar me dit ku ka keqpërdorim po jo llaba lluba keqpërdorim a e kupton, në qoftë se ty të përzihen nocionet që krejt qytetarët e Komunës së Shtimes e

dinë që të përzihen amani te koftë kursena. Fjala keqpërdorim është akuzë ti mundesh me bërë pyetje por kjo është akuzë, në qoftëse mendon se ka keqpërdorim e ki krejt legjitimitetin e botës me shkuar atje, por jo mi dezinformuar qytetarët keqpërdorim çdo treten fjalisë na tmerrove me këto nocione e tua që i nxjerrë prej gjepit pa e ditur çka je tu thënë, sinqerisht kursena se është, por ti sqaroje një herë me vetveten çka je tu thënë.

**z.Rexhep Gashi;** Kryetar në qoftëse e kupton dyshoj keqpërdorim edhe lypi sqarim diçka tjetër është, ti nuk mundesh mu thirr këshilltar unë çka diskutojë, qytetarët më vlerësojnë unë çka diskutojë edhe ku thirrna. Nuk po e di unë ti roli yt çka është.

**Kryetari, z.Qemajl Aliu;** Unë jam Kryetari i Komunës së Shtimes.

**z.Rexhep Gashi;** A je këshilltarë i imi, unë nëse foli unë them jo ti, unë jam tu kërkuar sqarime prej zyrtares por ti nuk je ka dëgjon. Edhe mua me erdh mirë ma herët si kërkove falje që thave jemi në muajin e ramazanit dhe je lodh bukur gjatë edhe nuk je ka e din çka, unë kërkojë sqarim nga zyrtarja financiare që ne të na jep sqarim a ka keqpërdorim rreth këtyre sendeveçka i ngrita, në qoftëse ti mi jep ti jepmi jo zyrtarja ti pe luan rolin e zyrtares pe luan rolin e Kryetarit, rolin e avokatit s'pe di ti ku je edhe çka je tu dashtë me thënë.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Zotëri Gashi a vazhdojmë me sqarimet e zyrtares për financa.

**znj.Kimete Ukaj, ZKF;** Faleminderit për pyetjet, u cek cilat kanë qenë pagesat e bizneseve janë pjesë e qirave që janë të përfshinë por unë nuk i kam gjitha veç e veç por unë e paraqesgjithën si Komunë si total, se tani nuk shkoj na me drejtori cila drejtori edhe çka por tani këto janë përmbledhës krejt Komunës, kështu që i kam te të hyrat e shitjes së pasurisë dhe shërbimeve, d.m.th qitu janë hyre gjitha tani dhe qiratë edhe shërbimet që kanë qenë në shëndetësi edhe në arsim. U cek kontrata kolektive, për kontratë kolektive qe sa vite jo vetëm ne si Komunë por edhe Komunat tjera e kanë sjell ketë problem që përmbaruesi po i merr paret hiç pa na vetë Ministria Financave Thesari na jep dy dit afat dhe thotë tregoni ku po donë me ti marr paret, nuk te pyetje as qysh as hiq, na kanëmarr paret edhe ne jemi shtyrë me shkresa o mos mi merr qitu po qitu po nuk kanë vet hiç edhe na e kanë marr edhe ne ato kategori që sa e lejueshme me i marr. Nuk kemi kategori ose linjë buxhetore që dehët prej qendrës për këtë pagesën e kontratës kolektive, asnjëherë nuk kemi pasur linjë buxhetore që thotë kjo shumë paguhet për kontratë kolektive, nëse ceket se kjo shumë ose me buxhet si kategori e buxhetit ndahet për këtë kategori atëherë na s'kishim mundur mi prek kategoritë tjera po ishin paguar nga ajo kategori. Për sa janë marr a janë marr 400 mijë a 500 mijë ju i keni shumat këtu edhe për secilin njeri është e shkrinë është e marr paga mëditje që a shuma ma e madhe në paga mëditje është e marr në shuma mallra dhe shërbime kanë marr ne komunali, kanë marr në subvencion edhe kanë marr në kapitale, d.m.th për secilën kategori i keni këtu shumat sa janë marr, tani mos të hi me i shfletuar sa janë marr nëpër gjitha. Në kapital kanë marr në projektet që nuk janë realizuar tashme nis unë duhet me pas listën por mirëpo janë marr në ato projekte që nuk janë realizuar, nuk kanë marrë në ato projekte që janë realizuar, për pak najëkanë marr të hyrat, mirëpo e kemi dërguar një shkresë ma mirë ne të najë marrin grantin edhe ashtu që nuk janë realizuar projekte dhe i kemi liruar të hyratpër mi shpenzuar në vitin që jemi tani. U cek nafta 7200 euro tash kemi mi marr me listë mi shikuar ku kanë mbërritur edhe çka ka dhënë. Te lista e borxheve u diskutua dreke zyrtare te Apollonia edhe u diskutua Lumturie e cila është është biznes individual edhe kur të regjistrohen bizneset individuale tash me ligjin e ri që ka dal bizneset qe kanë qenë private kanë kaluar në emër te pronarit të biznesit kështu që edhe ajo ka qenë pronare e biznesit edhe u cek 999 euro shumë në emër të saj edhe ne Apollonia ka shkuardrejtori i administratës kanë pas delegacione edhe janë shkuar në ato dy restorante që po ceken këtu. Janë lëndë ato mundeni me ardhur mi marrë janë shënimet se tani këtu për mendshcilëndelegacion edhe çka u shkuar aty nuk mundem me dit, mirëpo për shkak të mbylljes e vitit dhe për shkak të afateve kohore që janë kanë datat e zotimeve u dashtë mi deklaruar si borxhe edhe janë shpenzuar. Me buxhet të këtij viti. Derivate kur th ojna përfshihen edhe derivatet nëse ceket për karburante atëherë shkojnë për karburante nëse ceket për gjenerator, po shkurtimisht më kodet e reja që janë ardhur 2024 vetëm ka me thënë derivate dhe lëndë djegëse për automjete dhe makineritë do me thënë nuk ceket ma as për gjenerator as për vetura as për kurrgjëhiç. D.m.th me kodet e reja që janë ardhur në 2024 ato përfshihen me një kod dhe ai është 13780 ku ka qenë kodi për vetura zyrtare aty ka qenë nafta

për karburante për vetura. Karburante 7200 a pe shiheni që shkruan naftë për ngrohje qendrore, e kemi rezervarin e komunës këtu që merret shuma e caktuar jo nuk kemi di kund tjetër për vetëm Komunës edhe u marr vetëm për Komunë pra na nuk marrim muaj për muaj por kur mbushet rezervarët në tre muaj katër muaj mbushen një hererezervarët e paguajmë atë shumë mandej na nuk marrim ma për atë për periudhën e parëtani pa u shpenzuar as na s'mundemi me marr se s'kemi ku me lënë. Te shërbimet kontraktuese të tjera u cek edhe kjo shërbime kontraktuese tjera, atëherë a ai kod ekonomik ku na epet për kryerjen e ndonjë shërbimi po tani thash me kodet e reja kanë dal edhe shërbimet teknike kanë dal lloj shërbimi tjetër, mirëpo përpara nuk ka qen ka qen vetëm një lloj si transporti i nxënësve na këna paguar nuk ke pas ku me dërguar tjetër kund e kanë dërguar në shërbim se na e ka kryer një shërbim. D.m.th kanë hyrë ato shërbime që kryhen shërbimeteknike shkon aty për rregullim diçka të automjeteve ose pra për derivate 7200 është vetëm për derivate nuk është për mirëmbajtje apo rregullimin e automjeteve. Te Drejtoria e Inovacionit se shumë po diskutohet edhe shumë po përflitet u fole dhe ma herët, si drejtori nuk ka kod buxhetor edhe përpara edhe tani, kështu që këta punëtorët paguhen në drejtori përkatëse kemi pyetur ne Ministri dhe ju kemi treguar si është puna na e kemi formuar tani drejtorinë na tani s'mundemi me heq edhe ku te paguhen edhe çka të paguhen, punëtorët kanë thënë të shkojnë të Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik. Është e planifikuar buxheti për paga nuk mundemi me thënë që nuk ka pare po e kemi futur aty për me funksionalizuar se s'mundemi na me lënë drejtorin pa pagë a po kuptoni.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Për mi kuptuar këto sene duhet mi lexuar nja dy libra te ekonomisë, e jo vetëm me ngrit akuza se s'është mirë, buxheti ka kaluar në tetor me vonesë pas bllokadës, Drejtoria e Inovacionit e Bujqësisë dhe e financave që janë bërë 11 drejtorikanë kaluar në këtë vit e di që si din ti je doktor ti mundesh me më treguar për najë vaksinë jo për këtë punë, dëgjo po ju tregoj se pome vjen keq se shumë po ja huq a po din edhe është një fjalë e urtë është mirë mes me i ditë senet ndonjëherë kur buxheti kalon ne tetor është normale që nuk kod buxhetor. Duhet me fol me këta se nuk janë në tok të bukës, sot i paskan stërvit me ardhur me bezhurmë këtu. Unë me ty s'merremkurrë për anën profesionale zero je Adelinë nuk te vlerësojëhiç, jo ti je lumi ne që te kemi në Shtime ty jam ekspert i ekonomisë jam mësues për ty.

**Kryetari, z.Qemajl Aliu;** Kryesues, Faleminderit shumë për fjalën, edhe unë i kuptojë që disa njerëz nuk ndihen mirë se me qenë vajzë e një fshati që ke mbajtur pengë dy vjet me votën tende çerdhen, normal që nuk ndihesh mirë mos qofsha në lëkurën tënde se problem është e di. Asllan nuk ka faj se dy vjet me mbajtur peng çerdhen ai fshat duhet me ja dit për nder kësaj e para. E dyta mu kthye te raporti mu adreson nja dy tre çështje që kisha pas qejf mi sqaruar për juve për qytetarët për koleget ne ekzekutiv e për te gjithë. Nafta ju e dini tri objekte 7200 euro u përmend tri objekte në Komunën e Shtimes e kanë klimatizimin, klimatizimi do me thënë edhe ngrohje edhe ftohjen e kanë me naftë, thua ti që na jemi tu jetuar ne Kuvajt, me naftë i kemi gjetur do me thënë Objekti i Komunës, Palestra Sportive edhe Qendra e Kulturës ngrohen edhe ftohen me naftë, kështu që e kuptoni që 7200 euro, prandaj 7200 euro janë shpenzuar naftë. Kthehemi te kontrata kolektive njëri nga asamblistët e përmendi që keni thënë që do ta paguani kontratën kolektive, po unë nja dy sqarime dua me i dhënë, mirë është me respektuar njëri tjetrin me n dëgjuar, sa i përket kontratës kolektive, kjo kontratë deri sa e kemi marr qeverisjen ne nuk është paguar, me një përllogaritje që e kemi bërë me zyrtarët financiarë diku kontratës kolektive që është ilegale për bindjen tonë dhe të Qeverisë duhet ti paguajmë 3 milion euro vullneti jem edhe Qeveris tonë ekziston normal vetëm për me ja paguar 3 milion euro kontratës kolektive që e kemi trashëguar, sepse komunat tjera kanë filluar prej 2014 me paguar edhe e kanë paguar, ndërsa ne në 2022 e kemi marr edhe ne nuk e kemi gjetur as hiç ma shumë se 10 mijë euro nga këto 3 milion të pagune. Tashti për kundër vullnetit edhe dëshirës për me ja u paguar kontratën kolektive edhe ato çka derivojnë nga kontrata kolektive qytetarët, mësimdhënësit administrata e kupton që Komuna e Shtimes me ja paguar 3 milion euro kontratës kolektive duhet nja tre vjet me ju thënë qytetarëve te Komunës së Shtimes na po agjërojmë jemi në agjerimd.m.th borxh a ky a para. E dyta dikush nga asamblistët e tha ka po vinë ato ka po vijnë po vijnë zotëri se shumica e juve keni qenë edhe në asamble keni kaluar shpronësime përmes votës juaj në të kaluarevetëm me një vendim 33 prona i keni shpallur zonë me interes, pa e pasur asnjë cent për shpronësim në konton e komunës qe edheketë me një përllogaritje të shpejt që e kemi bërë janë 5 milion

euro borxh të trashëguar prej jush prej vendimeve te juaja pra bëjnë 8 milion. Një vendim që prape ish qeverisja e ka marr në vitin 2009 edhe pse ato asete ju kanë bart KRU Prishtina por për popullizem dhe për votë i ka shpallur zonë më interes pronat ku janë puset në fshatin Davidoc, që aty janë mbi 10 hektar edhe për mi përkthyer në vlera te tregut janë mbi 25 milion euro në total 25 plus 5 plus 3 bëjnë 33 milion euro borxh na keni shtineve edhe Komunën e Shtimes me vendime të pa përgjegjshme që i keni barë nën efektin e votës edhe marrjes së votës elektorale edhe tani unë me koleget e mi edhe me zyrtaren kryesore financiare çdomëngjes që e hapim derën e Komunës duhet me këqyr sa aktvendime vijnë prej gjykatës me i paguar, këta e kemi bakshish prej jush edhe na edhe qytetarët e Komunës së Shtimes, e për këtë duhet me dhënë përgjegjësi dikush. 33 milion euro bashkish i kemi borxh nga vendimet e pa përgjegjshme të asamblesëkomunale, dikush dikur herë do kur ka mu marr me qeto, edhe tani leta din qytetarët e Komunës së Shtimes që ne jemi borxh 33 milion euro dhe çdo javë na vinë nga përmbaruesit që na e marrin na e plaçkitinkonton numrin. Kështu që kur ti bëni këto pyetjemirë është edhe mi dhënë përgjigje, këto përgjigje i keni zyrtarisht prej meje edhe prej qeverisjes tonë edhe leta din krejt qytetarët e Komunës së Shtimes dhe Republikës së Kosovës.

**z.Përparim Ramusa;** Unë së pari dua me ja sqaruar Kryetarit se çka është keqpërdorim që tha Rexha, keqpërdorim a me ble votë në Kuvend Kryetar, keqpërdorim a me hap konkurse për militantë, keqpërdorim është me paguar ekspertë 20 mijë euro me shkollë fillore, keqpërdorim a me ble kompjuterë me kontratë të negociuar krejt këto ti i ke bërë veç nuk ja dha hapësirën Kryesuesi Rexhes se pat mi thënë gjitha këto. Te kontrata kolektive me çfarë morali thuamë ka lënë Komuna borxh kur e dimë që Komuna e Shtimes i ka marr 2001 për ujësjellës, a mi lënë banorët pa ujë a, je zotuar Kryetar që kontratën kolektive në fillim të mandatit ka me realizuar, nuk je tu ja u paguar janë tu ti marr me zor paret asnjë vullnet ski me ja u paguar se me pas vullnet e kisha ndarë buxhetin, asnjë cent për kontratën kolektive se ke ndarë a tu ti marr me zor edhe baje se ke mundur me projektuar ne buxhet se ke projektuar plus që tha Reshati leje qe je tu ja u paguar borxhin je tu paguar edhe procesin gjyqësorkamata, kështu që mos hap dezinformuat, kemi shpronësuar rrugë kemi me shpronësuar rrugë edhe në mandat tanin u shpronësuar rruga a u shpronësuar kjo Unaza e Vogël që pi thua. Sa herë të ka nevoja edhe kërkesa të qytetarëve kemi me shpronësuar për rrugë edhe për sheshe.

**z.Rrahman Jakupi;** Po ju drejtohem qytetarëve të Shtimes se e di që na përcjellin, na dëgjojnë edhe për disa koleg këtu qe nuk kanë njohuri dhe besoj që ju hyn ne punë kjo. Se ajo çka e tha Kryetari aktual i Komunës këtu është vetëm një fillim i përgatitjes së opinionit për me treguar vitin e ardhshëm që ka me humb grantin e përformancës, a e dini pse nuk janë ato çkai përmendi jo na keni lanë borxhe me qit dezinformat në popullat që këta me kanë lënë borxh, ashtu ke thënë prej fillimit po u banën prej fillimit deri vjet nuk ka pas borxh pasqyrat financiare kanë qenë gjitha ne rregull, ju vetë i keni votuar këtu në Kuvend. Ju keni qenë ai që ju keni premtuar mësimdhënësve, bile një informacion shumë i rëndësishëm për mësimdhënësit po atëherë se ka dit kur e ka marr mandatin ju ka thënë me shujta me paga jubilare me paga me krejt ka mi krye, por nuk e ka dit që gjykata të kërkon paraprakisht a e ke kontestuar ti qet dokument apo jo, ndërsa kur ka ardhur e ka pa që a s'po bajka vallahi, çka me bërë tani zyrtarit ligjor edhe gjykatës atje krejt qoj ne themelore një herë tani në apel qoj se nuk ndez tash qeto për tri vjet.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Ti more i ke dërguar 2016 a jena kanë na në qeverisje borxhe tuat janë.

**z.Rrahman Jakupi;** Ai u kanë në themelore u kanë proces kadal ka dal po ju keni thënë që kemi mi paguar.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Në 2014 kanë filluar pagesat në 2016 i ke dërguar ne gjykatë.

**z.Rrahman Jakupi;** Këta çka do që është e keqe këta e kanë bërë ka ndodh në qeverisjen e tyre thonë ndërsa na jena të mirëkëta janë të këqijtë, akëta vet ju kanë thënë themelores dhe në apel sa ma shumë mi zvarrit mësimdhënësit edhe gjithë ata tjerët. Për mua ke shqetësuese është të çështja e anëtarit të Kuvendit zotëri Rexhep Gashi sjellja e Kryetarit ndaj tina ishte sikur një rob , sikur një skllav ndaj robit të tije, i tregojëçka duhet me fol veç në Vetëvendosje njeri e gjanë, d.m.th lirinë e shprehjes me ja cenuar anëtarit të Kuvendit që Kryetari Komunës këtu vetëm nëse pyetët mundet me dhënënajë përgjigje sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, për ndryshe mi treguar anëtarit te Kuvendit çka me fol kjo është e turpshme, kjo është skandaloze nuk di unë çfarë Kryetari është i tillë që mundet me bërë një gjë me ja

cenua një anëtari të Kuvendit lirinë e shprehjes, me i treguar çka ki me fol ti, ti nuk guxon mes me thënë fjalën keqpërdorim more kemi me thënë se ka keqpërdorime të konfirmuara. Është çështja kohe të nderuar qytetarë te Komunës së Shtimes gjitha kanë mu konfirmuar, ndërsa kjo çështja e borxheve është vetëm një përgatitje e opinionit se në vitin e ardhshëm për shkak të vendimeve të kundërligjshme që ika marr ky Kuvend që është kriter minimal të cilin njërin prej tyre e përmendi zotëri Gashi pak më herët e unë e kam përmend atëherë kur ka qenë i kundërligjshëm i kemi thënë Kryesuesit edhe Kuvendit a është i kundërligjshëm, ka thënë po pse pe bjen në Kuvend te na dëgjoj she atëherë n ashta kishe përfituar grandin e përformancës.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** E kemi përfituar grantin e përformancës edhe në të ardhmën do ta përfitojmë.

**z.Rrahman Jakupi;** Katër vendime i ki të kundërligjshme flasim vitin e ardhshëm ,prandaj kjo propagandë nuk ju dhez juve sidomos te unë. Ja nisen me fol për të drejtorët e ri të nderua anëtarë te Kuvendit ju që keni provojë kogja gjatë e dini këto çështja,. E ngritën shumë mirë zotëri Reshati edhe zotëri Gashi ne kemi themeluar drejtori, realisht ne si kemi themeluar, Kryetari i Komunës e keqpërdor pozitën dhe autoritetin zyrtar ka themeluar drejtori të kundërligjshme, shikoni Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, shikoni statutin e Komunës së Shtimes nuk është ajo që thotë çdo vit fiskal lexoni edhe pak ma poshtë çkathotë atje, çdo vit fiskal i prezanton Kryetari, mirëpo drejtorit janë të kundërligjshme edhe kjo do të vërtetohet me kalimine kohës, do të vërtetohet keqpërdorimi i autoritetit zyrtar edhe gjitha këto, kështu që propagandat që në kemi borxhe na kanë lënë ata nuk qëndrojnë të nderuar qytetarë këtë do ta vërtetojmë kjo do të argumentohet është e argumentuar, kjo qeverisje e dështuar është çdo ditë duke bërë skandale dhe ato skandale që po krijoni po mundohet mi hedh te dikush tjetër, por realisht kjo nuk qëndron. Tri vite janë bërë hajde tregoni tash ku është suksesi juaj, për tri vite keni bërë vetëm skandale të cilat do të vërtetohen , ndërsa propaganda që po bëhet për borgje miliona nuk ekzistojnë.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Qytetarët isha lla shohin kësi lloj skandaleve që vijnë ka 20 milion euro në vit në Shtime, e për këtë pjesën e borxheve që i tha Kryetari e që po vinë prej gjykatave, Nuk janë duke ardhur në këtë mandat janë tu ardhur prej mandateve të kaluara, po janë tu ardhur por ju i keni dërguar jo na, na nuk merremi me këto sene.

**z.Reshat Mujota;** Faleminderit zyrtare financiare edhe të falim nderojë shumë për përgjigjet konkret dhe profesionale, të faleminderit për Drejtorin e Inovacionit që Kryesues manipulojë në fillim të mbledhjes edhe gjithmonë dhe gënjeshtar doleKryesueskëta po ta them të vërtetën, edhe Kryetar ter hekefjalën se edhe ti del mashtrues se Shtëpia e Kulturës nuk nxehet me naftë po ngrohet me pelet e kemi, jam shumë i sigurt për këtë punë, bane gabim kështu që këtë gabim mundem me ta fal se nuk i ki të dhënat se zyrtarja tha çka janë shpenzimet 7200 euro për Komunë tha janë për ngrohej të Komunës, kështu që nuk e ki se të demantoj tani shkojë te Shtëpia e kulturës edhe e fotografoj edhe kaldajën edhe krejt ti fotografoj edhe ti postojë që i bien edhe ti njëjtë si Kryesuesi. Drejtoria e Inovacionit asnjëherë në jetën e vetë kod buxhetor nuk ka pasur as në mandatin e kaluar as në këtë mandat kurrë kod buxhetor edhe është drejtori e jashtëligjshme, nuk e ke hapur drejtorinë e Inovacionit në vitin 2024, buxhetin krejt ma shumë se ju e di qysh o votuar buxheti, buxhetin ke bërë Pazar të votës edhe e ke kaluar në mënyren ma të keqe të mundshme edhe keni mi sjell probleme vetvetes me këtë kalim buxhetit. Po ta jap argumentin pse Drejtorin e Inovacionit e përmendi edhe në mbledhjen kaluar drejtoresha 65 mijë euro nuk i ki buxhet i ki donacion, tjetër send a buxheti tjetër send a donacioni nuk a buxhet ai, dikush këtu a tu m shef se kjo zyrtarja, unë i besoj zyrtarit financiare absolut politikes për veç dokumentit me kod buxhetor që ma prezanton edhe kjo të tregoj ka i marrin rrogat te Zhvillimi Ekonomik, d.m.th edhe këtu manipulon edhe me rroga e ky a keqpërdorim, e mban një drejtori e i pegun prej tjetrës drejtori ky a keqpërdorim me tupan keqpërdorim nuk a pak qaty pak qaty edhe merren. Tërhiqe fjalën Kryesues qe thave ka buxhet se zyrtarja financiare të demantojë absolut nuk e ndryshon as ligji as kush për veç fjalës së zyrtares financiare e di që keni mi bërë presion banvaki por kjo a është e obliguar mu përgjigjur në pyetjet që ja bëjmë ne.

**znj.Adelina Reshani:** Duhet me na e sjell informacionet ma te detajuar.

**z.Besnik Ahmeti, drejtor i Financave;** T'i sjellim por sa dush me t'i sjell ti si merr vesh, sa dush te qes numra ti si merr vesh.

**z.Reshat Mujota;** Tregoni me çka është ngroh Salla, këtë shpjegona se nuk është me naftëkaldaja aty.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** E mirë, verës me çka është ftohë salla, klima me çka ka funksionuar, me pelet a, klimat janë dhezë me pelet verës aty, ma bre zotëri Mujota, e di që është me pelet po e ka sistemin.

**z.Besnik Ahmeti, drejtor i Financave;** 7200 euro për 3 muaj ditë i bien 2.51 litra mu nxeh për metër katror, çka janë për tre muaj dy litra e gjysmë, mos bëni hajgare 7200 euro.

**z.Kimete Ukaj, ZKF;** Debati po nxehet edhe përsëri po vina qaty ku jena kanë, është nxehja qendrore 7200 thash është 3 a 4 muaj a e marrim vetëm qita tan vitin a jo, na tash deri sa të harxhohet rezervuari qita naftë e kemi, nuk mundemi me mbush nëse është plotë rezervuari çka kemi me mbush rezervuarin , sa është litra e naftës 1.5 a 1.3 sa po shkon litra, kjo është për qeta muaj për derivate. Ndodh edhe ngatërrohens'mundet mi dit krejt i dina na letrat janë mundemi me ardh mi marr, kështu që është ajo qysh është po themjanë ë rezerva që pa u harxhuar ajo nuk mundemi me ble tjetër, pra 7200 euro për tre katër muaj muas'po me duket fortë shumë e madhe.

**z.Rexhep Gashi;** Drejror, erdhe pak me vonesë edhe na elaboroj një dokument të tillë zyrtarja financiare, nuk thamë çka ka ndodh me ato po thamë kush ka janë ato edhe cilat objekte ngrohen me qeto 7200 euro lypëm sqarim, sqarimin na dha edhe ok është. Objekti i vetëm i Kuvendit Komunal koka me ngrohej qendrore sipas zyrtares, sipas Kryetarit koka edhe dy objekte tjera. Unë dua me dit cilat janë bre Kimete.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Zonja Kimete a ta përfundojmë këtë pjesë se është informatë edhe nëse kanëdiçka net lypin te qasja në dokumente zyrtare.

**z.Rexhep Gashi;** I falim nderojparafolësit e mi të cilët i ngritën disa shqetësime, por isha pikërisht edhe unë me marr fjalën dhe mi ngrit ato shqetësimet të cilat me të vërtet siç thash po dyshoj, dhe parafolësit i argumentuan se ka disa keqpërdorime, edhe thjeshtë uargumentuan prej Reshatit dhe gjithë tjerët në cilat, te nepotizmi.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Po leje bre mos fol për nepotizëm të lutna, mos dil te nepotizmi leni këto sene amani ju koftë, po çfarë nepotizmi krejt në zyre jeni ardh ne gujza keni nejt aty me marr drejtori po flisnikëtu rrini mos flisni për atë temë mos me shtini mu shpluar, rrini leje nepotizmi nepotizmi leje këtë punë. Po tensionohem se po del jashtë rendit të ditës.

**z.Rexhep Gashi;** Me mua kur të flasësh e thuash je ardh me kërkuar drejtori unë thamë më ke ofruar drejtoriedhe më ke ofruar ma shumë se drejtori.

Pika 6

<u>Propozim-Vendim për miratimin e vlerësimit të dëmeve të FN&FT për Janar-Tetor 2023</u>

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi:** Hapi diskutimin për këtë pikë. Edhe kjo ne KPF ka kaluar unanimisht, kjo ka të bëjë me fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera. Në bazë të rregullores tani duhet të kalojë që çdo damë që bëhet në Komunën e Shtimes të bëhet fillimisht vlerësimi nga komisioni pastaj komisioni ta sjell propozimin në Kuvend që të i drejtohemi me vendim Ministrisë së Bujqësisë për ti bërë pagesat. Është dhënë sqarimi në KPF dhe ka kaluar unanimisht.

**z.Përparim Ramusa:** Ashtu siç jemi marr vesh edhe ne KPF te dëmet që janë shkaktuar gjatë të reshurave çatë vitit 2023 e kemi votuar edhe prape do ta votojmë. Brenga dhe shqetësimi është sipas informatave që i kemi ne ekzekutivi me neglizhencën dhe papjekurinë e vet nuk ka arrit ta kompletoj dokumentacionin edhe i ka ikur granti prej nivelit qendror, këtë e flas me plot bindje arsyeja është se disa komuna që kanë qenë ma azhur dhe kanë arrit mi krye punët e veta i kanëdorëzuar me kohë materialet për dëmet në nivelin qendror dhe i kanë marr mjetet. Kjo do të thotë se diku 75 mijë euro komuna jonë nuk ka arrit mi marr si pasojë e vërshimeve dëmeve që ju kanë shkaktuar qytetarëve tonë për shkak të mos pjekurisë, mosdijes se ekzekutivit. Di do që të jetë unë jam për me votuar edhe nëse niveli qendror nuk gjen zgjidhje jemi që si nivel lokal tashikojmëkëtyrebanorëve qe ju kanë bërë dëmet me ja ukompensuar. Çështja ma me rendësi që unë dua me ngrit këtu është për një marrëveshje që u bërë në mes ish ekzekutivit në kohen kur ka qeveris Partia Demokratike. Siç e dini kolektori ka pas e ka vijënnëpër fshatin Belincë dhe fshatin Carralevë, i kam procesverbalet i kam gjithamarrëveshjet me gjithë

banorët. LëvizjaVetëvendosje as një cent nuk ju ka dhënë këtyre banorëve që ka bërë marrëveshje Komuna me ta jo marrëveshje individuale, ikam procesverbalet gjitha është bërë komisioni është dal edhe i ka vlerësuar gjitha dëmet dhe nuk ju kanë paguar. Unë për hire te korrektësisë dua mi cek edhe emrat gjitha ata banor dhe gjithë ata qytetarë të komunës tonë që janëdëmtuar me marrëveshje me komunën kolektori ka kalua punimet edhe ju kanë dëmtuar pronat dhe kush nuk a marr ma me ata njerëz. Janë qita banor: Ilir Emini, Gjevdet Veliu, Betim Brahimi, Sabri Cerkini Rizah, Shatmani, Gazmen Bajrami, Durak Bajrami, Ragip Heseti, Faton Shatmani, sigurishtë ka edhe tjerë dua mi cek edhe do paraprak që kanë qenë : Ahmet Ahmeti, Avdi Mustafa, Nuha Veseli, Xhevdet Jashari, Naim Aliu, Agim Syla, Metush Metushi, Sadat Seferi, Zaim Ahmeti edhe Nebih Bajrami, kërkojë falje nëse nuk kum arrit me përmend ndonjë emër të për veqshëm. Kështu që po lypi specifikim, po lypi informatë pse ekzekutivi i juaji që dy vite e gjysmë qeverisje nuk keni arritur sikur këto tjerat që pi bini ne Kuvend të paktën ato tjerat mi pru në Kuvend. Sa kam informatë unë një kod buxhetor jo për të gjithë diku 18 mijë euro ka qenë i zotuara edhe te alokune për vitin 2022 me ja u bërë pagesat, ju si ekzekutiv i keni marr ato mjete edhe i kini ri destinuar tjetër kund edhe banorëve në fjalë nuk ja u keni paguar dëmet hala. Si grup parlamentar kërkojmë që edhe këto kërkesa me hi ose nëse sa në këtë pako në një pako tjetër edhe se na ja u kemi shkaktuar dëmet, Komuna në bashkëpunim me operatorin që ka operuar për Kolektor ja u ka shkaktuar dëmet. Paraprakisht është një marrëveshje mes tyre që ju lejojmë me hy nëpër prona tonat për Kolektor me kushtin që vetëm dëmet të paguhen, ndërsa Komuna ende nuk ja u ka paguar.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Mirë që janë nënshkruar ato marrëveshje, paska pasur edhe marrëveshje tjera për shpronësime edhe për dëme që janë nënshkruar edhe nuk janë paguar asnjëherë, po me emër të Zotit do të paguhen gjitha vetëm kohë duhet

**z.Kastriot Shabani, drejtor i DZHE;** Faleminderit Kryesues, e mora fjalën për me dhënë një përgjigje zotëri Ramusa rreth subvencioneve apo siçquajte ti dëmet e shkaktuara në bujqësi. Si Komunë dhe si ekzekutiv me rregullore të brendshme e kemi me bërë prej ZKA-së një komision për vlerësim të dëmeve, pavarësisht ku ndodhë ajo, a ndodh në bujqësi a ndodh prej të reshurave atmosferike që janë, këto dëme e kemi për obligim na me ja përcjell Ministrisë përkatëse që i bien Ministrisë së Bujqësisë. Vlerësimi,çdo vlerësim që u be po foli për vitin 2023, komisioni ka dal dhe ka bë vlerësim për secilin dëm ose kërkesë që u bërë palëve të dëmtuara. Ministria përgjegjëse nuk e merr përgjegjësin për mi paguar dëmet nëse nuk ka buxhet, në fund të vitit e kemi pasur një email prej Ministrisë së Bujqësisë edhe na kanë thënë dërgoni emrat edhe listat e gjithë të dëmtuarve edhe po kjo procedurë të shkoj edhe përmes Kuvendit. Tani që po flasim këto kanë mu paguar se mjetet janë ndarë por është e rregulluar me ligj edhe siç po kërkon Ministria këto të shkojnë përmes Kuvendit, prandaj ka ardhur në Kuvend jo për diçka tjetër.

**z.Përparim Ramusa:** Drejtor faleminderit për sqarimin, as nuk e kontestova mënyrën e vlerësimit të dëmeve, çështja e dëmeve që kanë ndodhur brenda viti 2023, vetëm është vërejtja sipas informatave që i kemi që nuk janë dërguar me kohë. Tani n dëgjo dikush a tu gënjyer këtu. Qeveria ka marr zotim që donë mi paguar edhe disa Komuna i ka paguar, por nuk është telashe këtu, telash ja është me dëmet si Komunë në bashkëpunim me operatorin që ka kryer punët e Kolektorit vitin 2021 ju ka bërë dëme qytetarëve për atë po kërkojë sqarime se kjo është në rregull.

**z.Kastriot Shabani, drejtor i DZHE:** Për komision të vlerësimit të dëmeve e kemi edhe një email që dokument zyrtarë që e dokumenton këtë kur na e ka dërguar Ministria për mi përcjell vlerësimin e dëmeve. Sa i përket Kolektorit të Ujërave të Zeza dëmeve që janë shkaktuar. I kemi do auditor të jashtëm dhe është e vërtetë që kanë qenë të dara prej qeverisjes paraprake një vlerë 18 mijë euro, auditori i jashtëm thotë me rregullore të brendshme na e kemi votuar një rregullore të brendshme, thotë nuk ki drejt me nda pare ose që shkaktohen prej subvencioneve, përkatësisht kanë qenë në drejtorin teme, unë shtek që e shkeli ligjin për diçka unë nuk mundem, mua me vjen keq për ato dëme që ju kanë ndodhur atyre banorëve, por në qoftë se ma thotë mua një rregullore që nuk ki drejtë unë nuk e shkeli rregulloren, nuk guxoj më shkel, përgjigj na për ata e vërtetë unë kampasur edhe biseda me ata banor që ju kanëshkaktuar dëme, po çka net merren neti qojnë ato lëndë në gjykatë edhe gjykata net merret me ato lëndë. Nuk munde me dhënë mjete financiare për diçka qe ma ndalon rregullorja e punës, e që kjo është e specifikuar në atë rregullore.

***Kuvendi i Komunës së Shtimes, me 18 vota "Për", me 0 vota "Kundër" dhe me vota 2 vota"Abstenim", miratoi Vendimin për miratimin e vlerësimit të dëmeve të FN&FT për Janar-Tetor 2023.**

Pika 7

Draft-Plani lokal i veprimit për komunitetet Rom e Ashkali për 2024-2026 (për diskutim publik)

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Hapi diskutimin për këtë pikë. Në KPF kemi vendosur unanimishtë, gjithashtue dhe ne KPK që kjo të shkojë në diskutim publik.

**znj.Rrezartë Ramadani;** Përshëndetje për të gjithë, marr parsysh që numri më i madh i pjesëtarëve të Komuniteteve Ashkali jeton në fshatrat Vojnoc dhe Gjurkoc, kam një kërkesë që diskutimet publike të organizohen në këtë fshatra në mënyrë që të sigurohet një pjesëmarrje më e madhe e këtyre pjesëtarëve të Komunitetit, se dihet se ky plan veprimi është për avancimin e të drejtave të tyre dhe i prek drejtpërdrejt anëtarët e komuniteteve, kështu që në mënyrë që të organizohen në këto vendbanime por gjithashtu edhe në Kuvend këtu në Shtime, sepse anëtarët e Komunitetit Rom jetojnë në Shtime, ndërsa pjesa ma e madhe e pjesëtarëve Ashkali jetojnë në fshatrat Vojnoc dhe Gjyrkoc.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Këtë kërkesë duhet ta drejtojmë edhe te Zyra për Informim dhe ata e shohin ne bazë të rregullores se si duhet të veprojnë.

***Kuvendi i Komunës së Shtimes, unanimisht miratoi Vendimin për Draft-Plani lokal i veprimit për komunitetet Rom e Ashkali për 2024-2026 (për diskutim publik).**

Pika 8

Prop-vendim për formimin e Komisioneve për ndarjen e titujve "Sakrifica Reçakut-1999" dhe "Pena e Artë"

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Hapi diskutimin për këtë pikë. Do të thotë këto jemi dakorduar në KPF që ekzekutivi ti sjell emrat nga ekzekutivi dhe shoqëria civile, ndërsa Kuvendi ti jep propozimet pozitë opozitë për këto dy komisione.

**znj.Adelina Beqaj;** Në emër të Partisë Demokratike të Kosovës te komisioni për Reçakun e propozojmë Rexhep Gashin, ndërsa te Pena e Artë e propozojmë Albana Podvoricen.

**z.Besnik Seferi;** Marr parasysh që kemi koalicion bash me LDK-në dhe AKR—në si LëvizjeVetëvendosje kemi këto propozime, te komisioni Sakrifica e Reçakut 1999 të jetë Sanije Sadiki, ndërsa te komisioni Pena e Artë të jetë nga koalicioni Muhamet Ademaj.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Do të thotë te KomisioniSakrifica Reçakut-1999 Kuvendi propozon Sanije Sadiki dhe Rexhep Gashi, ndërsa i emëruar nga Kryetari Komunës është Adnan Ademi, Ruzhdi Jashari dhe Adem Ramadani nga fshati Reçak. Për formimin e komisionit Pena e Artë nga Kuvendi janë Muahamet Ademaj dhe Albana Podvorica nga ekzekutivi Lulzim Sahiti, Avdyl Hajredini dhe profesor Banush Imeri.

**z.Reshat Mujota;** Vetëm të sqarohemi me Kuvendin se Besnikun e kam prezent, kur te votojmë si Kuvend na jemi duke i votuar anëtarët e komisioneve. Na kemi hasur me një keqkuptim thuaja edhe keq vendim që nuk u kanë shumë i moralshëm edhe ai veprim mu be që ne nuk votojmë Kryesues të komisioneve as nuk kemi votuar në asnjërin komision, por na u ka caktuar Kryesuesi i komisionit me urdhër të Kryetarit me propozim të Kryetarit, që nuk jena kanë kundra emrit po procedurat janë shkelur pra na kemi reaguar në komision që prapepropozimin e zotëri Rushdi Jashari e kemi zgjedh Kryesues, por mos të bëhen këto gabime po bahen gabime për caktimin dhe çka është ma e keqja që anëtari tha që më keni votuar si Kryesues. Në gjitha procesverbalet dhe epen faktet që na votojmë anëtar të komisioneve, ndërsa komisioni i zgjedh Kryesuesit, ta keni parasysh ne kur të votojmë jemi tu zgjedh anëtarë te komisionit, ndërsa komisioni duhet ta zgjedh Kryesuesin e ati komisioni kush do që të jetë ai i propozuar dhe të merr shumicën e votave, kështu qe mos te keq informohet se këtu unëkam edhe një vendim që vet Kryesuesi ka nënshkruar një dokument të cilin Kuvendi nuk e ka votuar, do me thënë më një far forme e ke keqpërdor votën e Kuvendit mos te ndodh kjo.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Po zotëri Mujota është e vërtetë ka qenë një gabim prej anës së Sekretariatit edhe është nënshkruar gabim, sepseunë kam menduar që gjithë emrat janë anëtarë dhe nuk e kam vërejtur që është kryetari i Komisionit. Procedura duhet të shkoj ashtu siç tha zotëri Mujota mbledhjen e parë e thirr Kryesuesi i Kuvendit dhe aty zgjidhet Kryesuesi i komisionit e pastaj vazhdon Kryesuesi i komisionit sikur ne gjitha Komitetet që e kemi bërë, po ai ka qenë një gabim pa dashje nuk ka qenë diçka kështu. Unë e kam pranuar në momentin që e kam parë dokumentin e kam parë që është gabim. Me gjithë atë sqarimet u dhënë ne po votojmë sot vetëm anëtarët e këtij komisioni jo Kryesuesin e komisionit, Kryesuesi i komisionit zgjidhet në mbledhjen parë që mbahet nga anëtarët e komisionit.
***Kuvendi i Komunës së Shtimes, unanimisht miratoi Vendimin për formimin e Komisioneve për ndarjen e titujve "Sakrifica Reçakut-1999" dhe "Pena e Artë".**

Pika 9

<u>Pyetje – Përgjigje</u>

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Hapi diskutimin për këtë pikë.
**z.Muhamet Ademaj;** Pyetje për Kryetarin: Çfarë po ndodhë me objektin e vjetër të Stacionit Policor në Shtime, a ka Komuna ndonjë Plan konkret, dhe pyetja e dytëështë për Kryetarin: Ku qëndron puna me punimet e projektit për impiantin në huamarrje, ne pe shohim që është marr një kredi por nuk po shohim që dikush është duke punuar prej operatorëve në ketë drejtim.

**z.Hamëz Tërshani;** I kam dy pyetje për drejtorin e DSHP-në, por më mirë që edhe Kryetari që është këtu. Po më intereson kompania "Xhema Com" çfarë shërbime kryen në Komunën e Shtimes, arsyeja është që kam pasur informata edhe prej arsimtarëve atje te shkolla qëështë një kombi që gjatë gjithë ditës pozicionohet atje te plepat te shkolla fillore dhe nuk kryen asnjë shërbim. Unë gjatë javës ka me be kërkesë në qasje ne dokumente zyrtare, po më intereson prej Kryetarit nëse ka informata. Edhe jam informuar që Komuna e Shtimes e ka iniciuar njëkontratë për mbajtjen e parqeve që kap vlerën e 200 mijë eurove, po më intereson çka ka ndodh prej Kryetarit jena akuzuar shumë këna kosit shumë bari, çka po ndodh tani. Në kohen kur jena akuzuar që këna kosit shumë bari na kontratën këna pas njëkontratë 250 mijë euro për tri vjet, ndërsa tani vetëm për një vit 200 mijë euro mi buxhetu për mirëmbajtjen e parqeve unë kam drejt me kërkuar sqarim prej Kryetarit
**znj.Besartë Musliu-Spahija;** Kam dy pyetje për DPUGJK-në, pyetja e pareështëkërkesë për në fshatin Godanc i Poshtëm në rrugën "Kozhinca" janë diku rreth 5 familje të cilat kërkojnë rregullimin e kësaj rruge, dhe pyetja e tjetër është për lagjen Petroviq në rrugën "Brukseli" "Londra" dhe rruga "Berlini" si dhe rrugët e tjera që vazhdojnë me rend se kur do të bëhet asfaltimi i tyre.

**z.Reshat Mujota;** Kam pyetje për drejtorin e DZHE; Pritet faza e punimeve në projektin e rrugëve të arave kur fillojnë punimet dhe pjesa në fshatin Molopollc a do të vazhdojë ajo pjesë që ka mbetur në gjysmë e që nuk është vazhduar. Pyetje tjetër për drejtorin e DPUKGJ; Është një kërkesë e fshatit Molopollc që sheshi i Dëshmorit "Skender Salihaj" të rinovohet, dhe të bëhet tamam shesh ashtu siç i ka hije, sepse ai shesh është mbajt me mjete vetanake familjare, ndërsa e përmban një emër të një dëshmori dhe një heroit të kombit ka kërkesa te qytetarëve që ai shesh të investohet edhe te bëhet taman shesh ashtu si i ka hije. Dhe çështja tjetër te sheshi i Flamurit është i rrënuar komplet sheshi dhe do intervenim sa më shpejtë? Pyetje për DKA; Kam pyet dhe kërkuar për intervenim sa më të shpejtë për pastrimin e shkollës së djegur "Bajram Curri" në Molopollc atu duhet me bërë një intervenim se janë duke hyrëfëmijë të mitur që mundem edhe mu lënduar aty. Pyetje për DPUKGJ; Drejtor këtë kërkesë e kam paraqitur edhe më herët për një kanal kullues në arat aty ku është hy ajo pjesa e kanalizimit në vitin 2023 ai kanal është mbyllë dhe a ka mundësi me intervenuar sa më shpejtë.
Nuk është kanal i gjatë del diku 150 metra.
**znj.Adelina Beqaj;** Realishtmbledhjen kaluar kam bërë disa pyetje por Kryetari vendosi me protestuar por si do që të jetë qytetarët nuk murrën përgjigje. Mirëpo kësaj radhe nuk po dua me i përsërit por dua me i bërë nja dy pyetje tjera. Çerdhja e vjetër është premtuar se ka me filluar punën në Shtator, mirëpo

nuk ka ndodh ende dhe ka mbete ashtu siç është, çka po punoni në këtë drejtim dhe cilat janë punët konkrete që keni me i bërë në këtë Çerdhe për deri sa unë si Kryetare e grupit të grave e kam pasur një ide, por nuk jam përkrahur nga gratë e Vetëvendosjes për shkak se kanë thënë që ka me filluar Çerdhja . Pastaj te rruga "Ismail Qemali" para dy dite kam qenë aty dhe e pash gjendjen e rrugës që ishte katastrofa le, përveç që ishte prish, kishte gropa, ku ka qarkullim të shpeshtë të veturave, është një rrezik shumë i lartë, po lusë që drejtoria përkatëse të marrë masa të duhur.

**z.Rexhep Gashi;** I kam do shqetësime të qytetarëve që po bëjnë disa kërkesa dhe asnjë drejtori nuk është duke ju kthyer, e kam një kërkesë të një qytetari për ndarjen e një parcele për ndërtimin e një ndërtese për banimin e kategorisë së pleqve në bashkëpunim me humanistin Halil Kastrati, ende nuk ju ka kthyer asnjë përgjigje me shkrim, se pse nuk ju ka nda lokacioni.

**z.Besnik Seferi;** Kam disa pyetje. Sa i përket rrugës "Shefket Muhadini" dihet që vitin e kaluar është paraparë asfaltimi i rrugës që të qon deri te varrezat e Lagjes së Pajtimit, kjo nuk ka ndodhë, kur do të ndodhë në fakt kjo gjë. Dhe i përmendi parafolësja disa segmente të rrugës që janë të parapara të asfaltohen këtë vit, po dua ta di më saktë se kur? A do të ketë ndriçim këtë vit rruga "Abedin Murtezi" në fshatin Molopollc. A do të jetë në rend të parë renovimi i shkollës në Lagjen e Pajtimit para te gjitha shkollave tjera e cila është shumë me prioritet?A janë duke u inspektuar punimet e ndërtesave që janë ndërtuar në Komunën e Shtime. Kur do të filloj pastrimi i varrezave në Shtime dhe fshatrat për rreth.

**z.Asllan Beqa;** Kam dy pyetje për drejtorin e DPUGJK-së. A planifikohet sivjet ndriçimi në rrugën "Gjon Buzuku" segmenti Skënderbeu në fshatin Belincë. Punimet që janë duke u zhvilluar në kanalizimin në rrugën e Petrovës, kur priten të përfundojnë sipas kontratës dhe a kanë me intervenuar në asfaltimin e asaj pjesë që është duke u punuar?

**znj.Adelina Beqaj;** Kam një kërkesë që pika Pyetje dhe Përgjigje në mbledhjen e ardhshme të jetë në fillim je tu e parë efektin si pikë, nuk i kemi as drejtorët, asamblistët nuk po janë në sall për punët e veta. Tu kisha lut ti kthehemi normaliteti qysh kemi qenë që ta kemi këtë pikë si pikë tëdytë të rendit të ditës.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Nuk është problemi im që asambleisti nuk qëndron në sallë. Asamblisti paguhet merr mëditje dhe paga për me qëndruar në sallë edhe nëse e lëshon sallën para kohës nukështëproblemi im ai. Pika e dytë edhe drejtori e ka ftesën që sot ka mbledhje. Unë jam Kryesues e udhëheq mbledhjen por nuk jam që me dal aty te dera edhe mi ndal me zor kush don me qëndruar këtu. E sa i përket pyetje përgjigje besoj qe edhe në seancën tjetër do të jetë njëjtë sikur që ka qenë sot. Arsyeja pse, sepse po krijohen shumë interferime të njëri tjetrit te pyetje përgjigje po dalimkrejt jashtë kontrolle, po mendoj nga një herë po ja hupim edhe imazhin Kuvendit. Ju kisha lut gjithsecili kur te shkoj na në shtëpi ta shohim veten, unë e kam si praktik e përcjelli edhe një herë seancën live kam qejf që ato gabimet që i bëjë mes mi bërë më e për qeta e kam parë që nuk është në rregull me qenë në fillim edhe bile bile shpesh herë kam menduar edhe me heq krejt.

**Kryetari, z.Qemajl Aliu;** Faleminderit për pyetjet, vetëm zotëri Ademaj në pyetje për Stacionin e Vjetër Policor, prof. edhe herëve tjera me sa e di unë e kemi diskutuar, ai është institucion i MPB( Ministrisë së Punëve të Brendshme), realishtësht një gjendje e pa këndshme aty ne kemi folur me Ministrin e Kulturës që ta funksionalizojmë si Muze të dhimbjes për shkak të torturave që janë zhvilluar, sidomos në vitet e 90- ta nga pushtuesi serb, nuk kemi gjetur mirëkuptim, d.m.th këto muze kanë kosto edhe donë infrastrukturë njerëzore që ku Ministria nuk mendon se i plotëson kriteret, sepse jemi Komunë e vogël, edhe tani me Planin Zhvillimor Komunal që jemi duke e ndërtuar do ta shohim çka mund ta destinojmë. Pas opsionit A qëkishim për Muze të dhimbjes tani duhet ta diskutojmëçka mund ta destinojmëbashkërisht. Për besë aty parcelë e vogël është nuk e di, ndoshta aty mund ti krijohet hapësirë për shkollën fillore "Emin Duraku" edhe për QPS-në, sepse ështëparcelë shumë e vogël, me gjithëatë mbete me parë në të ardhmen, ndërsa te Impianti ju e dini qëështë kjo është kontratë mes tri palëve. Në komunat Tjera ku ka qenë e nënshkruar kjo kontratë në Podujevë dhe Graqanicë ja kanë dhënë edhe një mundësi Kryetarit me vazhduar punën, me thënë të drejtën edhe ne kemi qenë pjesë të inercisë edhe ne ja kemi vazhduar mundësinë deri nëqershor me pa nëse ata munden me implementuar, deri nëqershor e ka afatin kompania për te kryer punët edhe po presim qe ajo me i krye, me gjithë atë nga ajo çka kemi parë deri tani ajo është një kompani e pa përgjegjshme dhe kam frik se mundet me i kryer punët, po deri

ne muajin qershor ja kemi vazhduar për ti dhënëhapësirë për ti kryer për ta implementuar projektin 100 për qind, mirëpo janë diku edhe rreth 300 mijë euro punë që duhet ti kryej operatori edhe janë shumë gypa që kanë mbet ju e dini atë parcelë. Është një nga ato kontratat e këqija që është trashëguar dhe realisht na ka shkaktuar shumë probleme. Për asamblistin Tërshani nuk merrna unë kush rregullon se nuk kam kohë mu marr, mundet drejtori i DSHP-së me tu përgjigjur. Njëpyetje qe e bërë që thave me ke akuzuarski akuzuar për bari, po është e vërtet për tre muaj ke kosit bari 83 mijë euro për tre muaj edhe ku ke kosit bari, vetëm Shtime Lipjan Shtime Ferizaj ato dizkat që e dinë ti edhe në varrezat e dëshmorëve edhe tëveteranëve. Do me thënë ajo është unë nuk e di pse e ke kthyer temë, sepse ajo është turpi yt edhe qeverisjes tuaj, është turp, ndërsa ne e kemi filluar një procedura të inicimit të një kontrate për shërbime publike e cila vërtet i ka 200 mijë euro po ajo do ta zgjerojë gamen e hapësirave që do ti mbulojë, varrezat e secilit fshatë dhe qytetit, hapësirat publike, sheshet dhe trotuaret, do ta diçka qëkurrë nuk është bërë në Komunën e Shtimes, minimumi tre deri në katër herë në vit varrezat e secilit fshatë dhe qytetit do të pastrohen edhe do të mirëmbahen, po edhe hapësirat edhe trotuaret edhe parqet që i kemi ndërtuar dhe do ti ndërtojmë. Në fakt ajo çka ne po bëjmë dhe qeverisja jote çka ka bërëështë se në fakt me 200 mijë euro terë territorin e Komunës së Shtimes do ta mirëmbajmë, ndërsa ju e keni bërë ne fushatë 83 mijë euro ke kosit bari, nuk ke kosit hiç bari por e dini ju qysh e keni quar ato pare, i keni avulluar ato vetëm ja keni lënë fajin që. Unë nuk e di pse e rikthen këtë temë se kjo ështëtemë e turpit a e kupton dhe turpi krenari nuk bëhet asnjëherë zotëri, ajo është turpi yt ma i madh

**z.Kastriot Shabani, drejtor i DZHE;** Dua të përgjigjem për Reshatin, për rrugët e arave, rrugën e fundit që e këna rregulluar është rruga Rrafshtina është e vërtetë, vazhdimi i rrugës Rrafshtina është këtë vit. Njëkontratë që pritet të lidhet shumë shpejtë procedurat e prokurimit, janëdi kund 10 km rrugë zhavorr dhe është 1km gypa për kanalet kulluese. Njëra prej rrugëve qëështë e përfshirë në këtë kontratëështë edhe vazhdimi rrugës Rrafshina edhe gypat te kanalet kulluese, vetëm duhet me pa tani sa metra është gjatësia e tyre. Ka dal kompania projektuese dhe e ka bërë një specifik në atë rrugën e juaj. Ekemi edhe një kontratë qëështë ende aktive me rrugët e arave por për shkak të reshurave që ka pasur këto ditë ka qenë në fshatin Zborcë rrugë ka pasur në Pejtërshticë edhe në fshatin Rashincë. E kemi pasur edhe një kërkesë prej asamblistit Rexhep Gashi, me qenë se shumë banor te fshatit Pejtershticë e kanë të pamundur me për shkak të reshurave gypave për kanalet kulluese dhe zhavorrsot kompania projektuese e ka thirru Zotëri Gashin edhe nesër fillojnë punët edhe për me kryer atë punë. Me mbarimin e kësaj kontrate besojë vazhdon kontrata tjetër e re që nuk besoj që ka me mbetur rrugë pa u shtruar me zhavorr me kontratën e re. Me qenë se janë di kund afër 12 km rrugë edhe besoj që i përfshinë gjitha fshatrat e Komunës tonë.

**z.Grejtalb Emini, drejtor i DPUGJK;** Sa i përket pyetjeve që u adresuan po mundohem me ju përgjigjur secilës veç e veç. Po filloje nga pyetjet e para sa i përket rrugës "Kozhinca" jo vetëm njëra rrugë te rruga "Kozhinca" po të gjitha pesë anekset e rrugës "Kozhinca", janë të projektuara të buxhetune me kode nga Ministria. Po ashtu kjo pjesa te Petroviqi rrugët "Londra", "Brukseli", "Parisi", janë katër pesë rrugë, njëra nga to që vitin e kaluar e kemi futur kanalizimin këtë vit asfaltohet. Sa i përket shesheve "Skendeër Salihu" edhe sheshit të "Flamurit", së pari me kontratë të mirëmbajtjes pas nënshkrimit duhet mu pastruar, pastaj me ndonjë grant të Ministrive ta bëjmë njërin nga ta shesh edhe park qysh jemi duke i bërë në secilin fshatë, sepse kemi zotim secilin fshat me pas një pjesë qendrore të fshatit ku kanë mundësi edhe fëmijët me shkuar. Rruga "Ismajl Qemajli" e dimëqyshështë gjendja e rrugës, jemi duke tentuar me grante të Ministrisë me bërë një rivelizim të asaj rruge, besoj që brena këtij viti këna bërë kërkesë dhe vitin e ardhshëm me u asfaltuar ajo pjesë. Mu lidh me Bsinikun, te rruga e varrezave është e vërtet qe ka qenë në kodin buxhetor si emërtim rruga e varrezave, te rruga e varrezave në Lagjen Pajtimit është një problem pronësorë, është një pjesë e rrugës diku 30 deri ne 40 metra fillim i rrugës është pronë private. E di që edhe Kryetarisë bashku edhe me Imamin e Lagjes së Pajtimit, e di që edhe ne koordinim me ty do të bëhet një takim me banorët e lagjes edhe do tëgjendet zgjidhja për atë pjeseäsfaltimin e rrugës së varrezave. Kemi mundësi me krye këtë vit me projektet e Lagjes së Pajtimit me futur ne buxhet. Rruga "Abedin Murtezi", ndriçimi është buxhetuar në vitin e kaluar kontrata dy vjeçare, këtë vit besoj që përfundon ndriçimi në atë pjesë. Te rruga "Gjon Buzuku"në Brlincëkërkesa ke e Asllanit, në këtë Lagje e kemi një kod në Drejtorin e Shërbimeve Publike për zgjerimin e rrjetit te ndriçimit, po ashtu edhe më

lejoni t'ju informojë që edhe Granti i Përformancës shumica e kostos financiare do të shkojë nëzgjerimin errjetit të ndriçimit publik në Komunë e Shtimes, këtu i bie mund të them lirishtë që 90 % deri në 95% do të mbulohet territori me ndriçim. Synim i joni është që deri nëfund të mandatit asnjë shtëpi mos me pas që nuk e ka ndriçimin publik para derës. Sa i përket rrugës "William Woker", pjesa e parë e kanalizimit prej 500 metra ka përfunduar, synimet i këna me vazhduar edhe 350 metra deri ne shtëpi at e fundit e pastaj është e buxhetune në kod të Ministrisë rehabilitimi i rrugës "William Woker" prej fillimi të rrugës deri te shkolla fillore "Emin Dursaku".
Pasi që diskutime tjera nuk kishe Kryesuesi mbledhjen e përfundoi në ora 14:56h

Procesmbajtësi
Shqiprim Hyseni
_______________

v.v.

Kryesuesi i Kuvendit
Adnan Ademi
_______________